



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë
E-Mail: rmuca@klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al


Nr. Prot. 1430/7

Tiranë, më 29.12.2019

Miratohet

Bujar LESKAJ

KRYETAR



RAPORT PËFUNDIMTAR AUDITIMI
PERFORMANCE
"PERFORMANCA E MBZHR-SË NË KUADËR TË ZBATIMIT TË
POLITIKAVE TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS"

Rinald MUÇA

Drejtore i Departamentit

Jopublik: Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion jopublik dhe qëllimi i tij është gjenerimi i përgjigjeve zyrtare dhe administrative gjatë të gjithë auditimit nga ana e subjekteve të përfshira në auditim.



Divizioni i Performancës, IT, Novacionit e Sistemeve në KLSH

@Performanca

1. RËNDËSIA E AUDITIMIT.....	4
1.1 Konteksti i problemit social.....	5
1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës.....	5
1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë.....	6
1.4 Subjekti nën auditim	8
1.4.1 Hyrje në subjektet në auditim.....	9
1.4.2. Politikat e institucionit/agjencisë	14
1.4.3 Pesha në buxhet	15
000/lekë.....	15
1.4.4.Risqet e aktiviteteve të subjekteve	19
1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	21
1.4.6 Feedback-u i subjektit në fazën e terrenit	21
2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT	22
2.1 Objektivi dhe problemi.....	22
2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit.....	22
2.1.2. Objektivi i auditimit.....	24
2.2 Përkufizimet dhe terminologjia	24
2.3 Kriteret	26
2.3.1 Kriteret e politikës	26
2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit	27
2.3.3 Kriteret teknike	27
2.3.4. Kriteret e tjera/Praktikat më të mira	28
2.5.1 Qasja/metodologjia e auditimit	30
2.5.2 Metododat/teknikat audituese.....	30
2.6 Rezultatet e parashikuara	30
2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë.....	30
2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit.....	30
2.6.3 Forma e publikimit.....	31
3. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËN PYETJEVE.....	31
A ka qenë efektiv menaxhimi i sektorit të peshkimit dhe akuakulturës nga MBZHR në zbatim të politikave për këtë aktivitet?	31
3.1 A ka siguruar MBZHR organizimin e duhur strukturor për menaxhimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës dhe a ka ndër marrë politika strukturore në mbështetje të këtij aktiviteti?	31
3.2 A është i plotë, gjithëpërfshirës, i zbatueshëm, bashkëkohor dhe i përditësuar kuadri ligjor që mbulon aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës?	38
3.3 A mbulohet në mënyrë efektive i gjithë vendi dhe i gjithë zinxhiri i aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës me monitorim, vëzhgim, kontroll, inspektim dhe mbikqyrje?	44
3.4 A menaxhohen në mënyrë efektive infrastrukturat e lidhura me veprimtarinë e peshkimit dhe akuakulturës?.....	53
4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	68
5. ANEKSE.....	72
6. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE	73

✂ LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
BE	Bashkimi Evropian
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i>)
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (International Standards of Supreme Audit Institutions)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
DSHPA	Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit dhe Akuakulturës
QNOB	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
EUROSAI	Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
EUROSAI WGEA	Grupi i Punës për Auditimet e Mjedisit në EUROSAI
OMP	Organizata e Menaxhimit të Peshkimit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
SKP	Strategjia Kombëtare e Peshkimit 2016-2021
MKV	Monitorim-Kontroll-Vëzhgim
OSZH	Objektiva Specifike Zhvillimi
KA	Kritere Audituese
SIMP	Sistemi i Informacionit të Menaxhimit të Peshkimit
KPSHA	Komisioni i Përhershëm i Shqyrtimit të Ankimimeve
PO	Programi Operacional
QGDMS	Qendra e Grumbullimit dhe Depurimit të Midhje Sarandë
KKQPA	Komisioni Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën
KKKSHTE	Komiteti për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik
GFCM	Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (General Fisheries Commission for the Mediterranean)
SMP	Sistemi i Menaxhimit të Peshkimit
PSO	Procedura Standarde Operacionale
PMP	Plani i Menaxhimit të Peshkimit
IP	Inspektoriati i Peshkimit

1. RËNDËSIA E AUDITIMIT

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Në filozofinë drejtuese të KLSH-së auditimit të performancës i kushtohet gjithmonë një rëndësi e veçantë në shtimin e numrit të auditimeve, rritjen e cilësisë së tyre, zgjerimin e fushave të auditimit si dhe rritjen e ndikimit të auditimeve në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Misioni i KLSH-së si një institucion i pavarur kushtetues, është t'i shërbejë qytetarit shqiptar, duke qenë "agjent" i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.¹

Kontrolli i Lartë i Shtetit prej disa vitesh është anëtar aktiv i Grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit (EUROSAT WGEA) dhe në këtë kuadër kryerja e auditimeve që kanë në fokus çështjet e mjedisit apo të bujqësisë është gjithmonë e përfshirë në planin vjetor të auditimeve. Vendi ynë ka rezerva të shumta ujore, ka një vijë bregdetare mbi 300 km, shumë lumenj si dhe shumë burime e liqene natyrore, kjo pozitë gjeografike dhe këto karakteristika e rendisin atë ndër vendet e para në Europë për sa i takon burimeve të ujit. Gjithashtu kjo përbën edhe një burim natyror për zhvillimin e peshkimit dhe akuakulturës të cilat mund dhe duhet të sjellin një kontribut domethënës në ekonominë vendase apo dhe në zhvillimin social ekonomik të zonave përkatëse.

Fokusimi për të kryer një auditim në këtë fushë/aktivitet vjen si rezultat i problematikave të herë pas hershme që janë ngritur nga palët e interesit. Pikënisjet për të kryer këtë auditim janë marrë nga hulumtimi i bërë në artikujt mediatikë të cilët pasqyrojnë problematikën e komunitetit të peshkatarëve dhe nga progres raportet e BE-së që shprehen mbi ecurinë dhe zhvillimet e bëra në sektorin e peshkimit.

Disa nga problematikat që kanë shërbyer si indicie për të kryer këtë auditim janë²:

- Ndarje jo e qartë e detyrave dhe mungesë koordinimi institucional;
- Mungesë stafi të kualifikuar për të ushtruar kontrole që do të eliminonin peshkimin ilegal;
- Sistemi i monitorimit të anijeve të peshkimit nuk funksionon që nga muaji mars 2017.

Sektorin e peshkimit dhe akuakulturës përballë sot me një sërë problemesh dhe sfidash dhe ky sektor nuk është mbuluar më herët me auditime nga ana e KLSH-së, kështu që nëpërmjet këtij auditimi do të nxirren në pah boshllëqet, dobësitë, problematikat apo anët pozitive të këtij aktiviteti si dhe nëpërmjet rekomandimeve përkatëse KLSH do të japë kontributin e saj në përmirësimin e gjendjes. Rëndësia e këtij auditimi ka të bëjë me vlerësimin e zbatimit të politikave të hartuara për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës si dhe me vlerësimin e performancës së të gjitha strukturave përgjegjëse dhe të përfshira në menaxhimin e këtij sektori.

¹ Vendim i Kryetarit të KLSH nr. 229, datë 31.12.2017 "Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH- së për Periudhën 2018 – 2022".

²Progres Raporti i BE-së viti 2016 dhe 2018.

1.1 Konteksti i problemit social

Peshkimi bazuar në të dhëna arkivore dhe dokumentare është një nga zanatet më të vjetër që është ushtruar nga njeriu. Përveç se është një burim ushqimor, peshkimi ka edhe benefite të tjera siç është punësimi apo të ardhurat financiare që arrin t'i sigurojë personave që e ushtrojnë atë, gjë që tregon për kuptimin social dhe kulturor që përfitohet nga kjo veprimtari. Peshkatarët, familjet e tyre dhe pjesë më të gjera të komunitetit përfitojnë nga peshkimi. Në zonat ku peshkimi menaxhohet dhe ku peshkohet nga vetë komuniteti, të ardhurat që përfitohen prej tij nga shteti mund të shkojnë edhe në projekte që do të përmirësonin infrastrukturën dhe shërbimet që i ofrohen këtij komuniteti ose si një suport për përmirësimin e vetë kushteve të ekosistemit, gjë që në vendin tonë është tepër e vështirë duke qenë se investimet janë shumë të pakta. Njerëzit shpesh kthehen tek burimet natyrore si një mundësi për sigurimin e kushteve financiare dhe ushqimore kur opsionet e tjera të jetesës janë të kufizuara dhe në këtë mënyrë peshkimi mund të veprojë si një rrjet sigurie për shtresa të caktuara. Në të gjithë vendin ka njerëz të punësuar në sektorët e peshkimit dhe akuakulturës. Pjesa më e madhe janë të përfshirë në fusha të vogla. Industritë e lidhura, siç janë procesi i përpunimit dhe marketingu i peshkut gjithashtu mund të ofrojnë mundësi të mira për punë.

Peshkimi është një burim i rëndësishëm i ushqimit, punësimit, ekonomisë, aktivitetit çlodhës apo argëtues për njerëzit. Menaxhimi i burimeve të peshkimit është jetik për gjeneratat aktuale dhe të ardhshme. Në zonat bregdetare varësia nga peshkimi si një burim ushqimi është mjaft e lartë pavarësisht kushteve të vështira që ofron Shqipëria. Një masë e konsiderueshme e popullsisë, veçanërisht ata që banojnë në zonat e ku është e mundur të ushtrohet ky aktivitet, peshkimin e kanë si një nga burimet kyçe të jetesës. Peshkimi në ujërat e brendshme është veçanërisht i rëndësishëm për sigurinë e ushqimit të komuniteteve të varfra, pasi shumica e prodhimeve të peshkut në ujërat e brendshme prodhohen për mbijetesë ose konsum lokal.

Akuakultura është e ngjashme me shumë sektorë të tjerë të bujqësisë, ajo përdor burimet natyrore dhe metodat organike të bujqësisë dhe ndër vepron me mjedisin. Megjithatë, ka shumë polemika që dalin nga ambientalistët, për shkak të shqetësimeve në rritje të ndikimeve negative në botë. Në përgjithësi, angazhimi për bujqësinë dhe akuakulturën e qëndrueshme që nuk ndikon negativisht në mjedis është zgjidhja kryesore për këto çështje. Të nevojshme janë ndërgjegjësimi i publikut, si dhe pjesëmarrja nga të gjithë sektorët, duke përfshirë konsumatorët dhe prodhuesit. Aktualisht, ndërgjegjësimi i ndikimeve negative në botë dhe njohja e ndikimeve të mundshme ekologjike janë në rritje në mesin e të gjithë sektorëve.

1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës

Sipas përkufizimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), auditimi i performancës është një "shqyrtim i pavarur i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizmave të saj, me fokus të veçantë ekonomikitetin dhe me synim përmirësimin". Auditimi i performancës mbështetet mbi vendimet e marra ose objektivat e përcaktuara nga Ekzekutivi dhe mund të kryhet në të gjithë spektrin e sektorit publik. Ai dallon nga auditimet standarde financiare apo të ligjshmërisë pasi karakterizohet nga fleksibiliteti në përzgjedhjen e subjekteve, objekteve, metodave dhe dhënien e opinionëve dhe rekomandimeve. Auditimi i performancës është një metodë moderne

nëpërmjet të cilës taksapaguesit, financierët, vendimmarrësit, ekzekutuesit, media dhe shoqëria në përgjithësi ushtrojnë kontroll mbi mënyrën e kryerjes së punës dhe arritjen e objektivave nga ana e enteve shtetërore. Ky lloj auditimi nuk ka si synim të kritikojë entet e mësipërme, por të arrijë korrektimet e duhura, përmirësimin e 3E-ve dhe rritjen e mirëqenies sociale përmes aktiviteteve publike.³

1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë

Auditimet e performancës që janë kryer nga KLSH gjatë viteve të fundit kanë pasur një rritje të konsiderueshme në numër dhe në cilësi në fushën social-mjedisore. KLSH duke qenë edhe pjesë e EUROSAI dhe INTOSAI Working Group on Environmental Audits ka rritur fokusin e saj për auditimet me perspektivë mjedisore duke përfshirë gjithnjë në planin vjetor të punës temat mbi mjedisin dhe bujqësinë. Dhe është pikërisht ky fokus i KLSH-së që vjen në këtë angazhim të ri mbi çështjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimet e sektorit të peshkimit dhe të akuakulturës. KLSH ka kryer edhe më parë auditime në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke realizuar auditime përputhshmërie dhe rregullshmërie, auditime financiare si dhe auditime performance. Disa nga auditimet që mund të përmendim të cilat kanë një lidhje direkte apo indirekte mbi peshkimin dhe akuakulturën janë:

- ❖ Auditimi i Performancës me temë **“Zonat e Mbrojtura Detare”**, i kryer në vitin 2018. Disa nga gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi janë⁴:
 - AdZM nuk vihet në dijeni mbi urdhrat e ndalimit të peshkimit të lëshuara nga Ministria/inspektorati përkatës për periudhat e ripopullimit të specieve, shpalljen e zonave të ndaluara të peshkimit, etj. Po kështu, AKZM/AdZM Vlorë nuk janë përfshirë për konsultim gjatë diskutimeve për draftimin e Ligjit nr. 103/2016 “Për akuakulturën”;
 - Ende nuk ka një studim të plotë social-ekonomik mbi peshkimin lokal. Është zhvilluar një studim mbi llojet dhe trendet e këtyre specieve në zonën Karaburun-Sazan, megjithatë AdZM ende nuk zotëron një vlerësim të plotë të bazës së rezervave të peshkut;
 - Nuk janë marrë masa për hartimin e akteve nënligjore në funksion të Ligjit nr. 103/2016, datë 20.10.2016 “Për akuakulturën” dhe konkretisht ende nuk janë vendosur “Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë”;
 - Drejtoria e Peshkimit dhe Akuakulturës pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe AdZM Vlorë, të marrin masa për krijimin e një komunikimi të ndërsjellë për çdo rast nxjerrjesh njoftimesh, urdhërash, apo akte të tjera administrative që lidhen me lejimin apo ndalimin e aktiviteteve të peshkimit dhe akuakulturës brenda apo në afërsi të zonë së mbrojtur, si dhe nëpërmjet inspektorëve përkatës të verë në dijeni AdZM-në mbi ecurinë dhe rezultatet e masave të marra ndaj shkelësve, që vijnë nga sinjalizimet e AdZM-së;
 - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, AKZM, AdZM dhe me ndihmën e ekspertëve të fushës, të marrin masa për realizimin e studimeve të thelluara shkencore mbi zhvillimin e aktiviteteve të akuakulturës në afërsi të zonave të mbrojtura detare, që nga studimi i kapaciteteve mbajtëse të gjirit të Vlorës, e deri në vlerësimin e dëmeve

³Ekonomicitet, Eficiencë, Efektivitet; ndërkohë që nga zhvillimet e fundit promovohet aplikimi i 6E-ve, së bashku me Energy, Environment, Ethics (Energji, Mjedis, Etikë).

⁴Raporti Përfundimtar i auditimit “Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura Detare”

të akumuluar dhe ato potenciale në të ardhmen. Në këtë kontekst, këto organe të marrin masa për mos dhënien e lejeve të ushtrimit të kësaj veprimtarie deri në publikimin e rezultateve përfundimtare të studimeve. Në rast se nga këto studime del e nevojshme, të merren masa edhe për pezullimin e aktiviteteve që operojnë aktualisht në afërsi të kësaj zone. Po kështu, të veprohet edhe për rastet e Zonave të Përcaktuara të Akuakulturës referuar Ligjit nr. 103/2016, datë 20.10.2016 “Për Akuakulturën”, të cilat të përcaktohen vetëm pas zhvillimit të studimeve shkencore dhe jo sipas interesit të subjekteve private;

❖ Auditimi i përputhshmërisë **“Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”**, i kryer në vitin 2017. Në këtë auditim ndër të tjera është analizuar edhe sektori i peshkimit dhe akuakulturës ku përkatësisht është trajtuar si vijon: “Në procedurat për prokurimin e shërbimit të mirëmbajtjes të sistemit Blue-Box, është konstatuar se në dokumentet e tenderit dhe të ofertave, nuk është bërë ndarja e shpenzimeve në kosto operacionale dhe kosto mirëmbajtje. Ndarja në dy pjesë e shpenzimeve është e domosdoshme, pasi burimet e fondeve për mbulimin e tyre janë të ndryshme. Shpenzimet operacionale mbulohen nga subjektet private (anijet e peshkimit) ndërsa kosto e mirëmbajtjes të sistemit Blue-Box përballohet nga buxheti i shtetit ... Për sa më sipër KLSH ka dhënë rekomandime të cilat parashtrihen në vijim⁵:

- MBRZHAU menjëherë të marrë masa për anijet e peshkimit, që ato të paguajnë në numrin e llogarisë të përcaktuar nga ministria, shumën vjetore të transmetimit satelitor apo mesazheve me sistemet e tjera. Gjithashtu, të ndiqet rruga ligjore për arkëtimin e detyrimit nga subjektet private (anijet e peshkimit), për shpenzimet e shërbimeve operacionale, fonde që padrejtësisht janë mbuluar nga buxheti i shtetit;
- Për tenderat në vazhdim, me objekt shërbimi dhe mirëmbajtje të sistemit Blue-Box apo tenderat me këtë objekt të ngjashëm, ku shpenzimet varen nga kohëzgjatja e kontratës, autoriteti kontraktor të kërkojë në DT, që operatorët ekonomikë të paraqesin ofertat e tyre bazuar në kostot mujore të kryerjes së shërbimit, mbi të njëjtën bazë edhe autoriteti kontraktor të bëjë vlerësimin e ofertave.

❖ **“Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë”**, i zhvilluar në vitin 2018 në MBZHR. Ky auditim është kryer në bazë të programit të auditimit nr. prot. 1011/1, datë 07.09.2018. Nga ky auditim rezulton se: “Programet e ministrisë kanë rezultuar me një rritje të theksuar të kërkesave të paraqitura në PBA 2018-2020, ku ndër to ishte dhe Mbështetja për Peshkimin, si vijon⁶:

- Shpenzime të tjera me një rritje në shumën 0.011 miliard lekë;
- Investimet me financim të brendshëm me një rritje në shumën prej 0.05 miliard lekë;
- Investimet me financim të huaj me një rritje në shumën prej 0.217 miliard lekë.

Domosdoshmëria e rritjes së kufirit të shpenzimeve për këtë program është kushtëzuar nga krijimi i një sistemi të dhënash për hartimin e politikave në peshkim, hartimin e rregullave dhe detyrimeve teknike të zhvillimit të sektorit dhe të hedhjes së

⁵Vendim nr.49, datë 30.04.2017 Për evadimin e materialeve të auditimit në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”.

⁶ Raporti përfundimtar i auditimit “Auditim Financiar dhe Përputhshmërie” në MBZHR.

prodhimit në treg, të mbështetjes së tij në ndërtimin e infrastrukturës, si dhe të mbështetjes së zonave që varen nga peshkimi dhe akuakultura. Domosdoshmëria e rritjes së kufirit të shpenzimeve për këtë program është kushtëzuar nga Dokumenti Sektorial i Peshkimit (IPA II) dhe bashkëfinancimi i projektit Dokumenti Sektorial i Peshkimit (IPA II).

- ❖ Auditime ndërkombëtare të zhvilluara nga SAI-t homologe lidhur me peshkimin dhe akuakulturën, të cilat grupi i auditimit i ka shqyrtuar janë:
 - Auditimi i kryer nga Gjykata Europiane e Audituesve në vitin 2017 me temë: “EU fisheries controls: more efforts needed”;
 - Auditimi i kryer nga SAI i Estonisë me temë: “Evaluating the food safety control systems in place governing the production and placing on the market of fishery products”;
 - Auditimi paralel i zhvilluar nga disa SAI të Europës me temë: “Audit of Environmental Monitoring and Fisheries Management and Control in the Baltic Sea”.

1.4 Subjekti nën auditim

Institucionet që u përfshinë në auditim:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, institucion në varësi të MBZHR-së.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave për peshkimin dhe akuakulturën, është institucioni që nëpërmjet strukturave të tij ndjek zbatimin e këtyre politikave. Për periudhën objekt auditimi strukturat e identifikuara me përgjegjësi direkte për zbatimin e politikave të peshkimit dhe akuakulturës brenda MBZHR-së janë: për vitin 2016 Drejtoria e Peshkimit me dy sektorë në përbërje të saj, Sektori i Politikave të Peshkimit dhe Sektori i Politikave të Akuakulturës dhe Ujërave të Brendshme⁷; për vitin 2017-2018 struktura ka ndryshuar në: - Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës (3 punonjës) si pjesë e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe - Sektori i Programeve të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës (3 punonjës) si pjesë e Drejtorisë së Programeve të zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.⁸


Gjithashtu në auditim është përfshirë edhe Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës si institucion në varësi të MBZHR-së.

⁷Rregullore e Brendshme e Veprimtarisë dhe Funkcionimit të MBZHR-së, miratuar më 10.02.2017.

⁸Urdhër nr. 168, datë 05.10.2017 Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së MBZHR-së”, i ndryshuar

Urdhër 520 datë 1.12.2017 “Për miratimin e Strukturës së MBZHR-së”

Figura 1: Skema e zërthimit të subjekteve nën auditim⁹



Punoi: Grupi i auditimit

1.4.1 Hyrje në subjektet në auditim

Aktiviteti i Peshkimit në vendin tonë menaxhohet dhe zhvillohet bazuar në Strategjinë Kombëtare të Peshkimit 2016-2021 e miratuar me VKM nr. 701, datë 12.10.2016, Ligjin nr. 64 datë, 31.05.2012 “Për Peshkimin”, Ligji nr 103 datë, 20.10.2016 “Për Akuakulturën”, Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet nën ligjore si VKM apo rregullore të dala në zbatim të ligjeve të sipërpërmendura. Ky sektor njihet si një sektor i vështirë dhe me risk pasi aktiviteti i tij është i lidhur ngushtë me kushtet meteorologjike dhe klimaterike. Strategjia Kombëtare e Peshkimit ka për qëllim prezantimin e një vizioni të përgjithshëm strategjik për zhvillimin afatmesëm të sektorëve të peshkimit dhe

⁹Rregullore e Brendshme e Veprimtarisë dhe Funksionimit të MBZHR-së, miratuar më 10.02.2017, dhe Urdhër nr. 42, datë 07.03.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së DSHPA-së”. Për vitin 2017-2018 struktura ka ndryshuar dhe sqarohet në vazhdim.

akuakulturës. Ajo përcakton objektivat dhe prioritetet e vendit tonë për sektorin e peshkimit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka për mision konceptimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe të reformës legislative në këtë sektor. Pra, misioni i MBZHR-së është zbatimi i programit të qeverisë në fushën e veprimtarisë së kësaj ministrie dhe më specifikisht në¹⁰:

- Hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe blegtoral;
- Hartimin dhe përafrimin e legjislacionit në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit rural në koherencë të plotë me kërkesat e BE-së;
- Mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, bimëve, dhe garantimin e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që mund të vijnë nga kafshët dhe cilësia e ushqimeve;
- Mbledhjen dhe përpunimin e informacionit bujqësor;
- Ofrimin e asistencës dhe informacionit për fermerët.

Në zbatim të programit politik të Qeverisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka si objektiv kryesor rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor, rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve bujqësore, blegtorale dhe të përpunuara brenda dhe jashtë vendit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe ato financiare. Me specifikiht objektivat e institucionit janë:

Përafrimi i legjislacionit me atë të BE-së;

- Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët;
- Garantimi i cilësisë së imputeve bujqësore;
- Garantimi i sigurisë ushqimore dhe mbrojtja e vazhdueshme e konsumatorëve;
- Siguri për cilësinë e ushqimit në treg;
- Kontroll i situatës veterinarë dhe fitosanitare;
- Mbështetje për agroindustrinë;
- Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale;

Për sa i takon çështjes objekt auditimi, MBZHR bazuar në Strategjinë Kombëtare të Peshkimit 2016-2021 është angazhuar në këto linja veprimi:

- Kuadrin ligjor, administrativ dhe institucional;
- Peshkimin detar;
- Peshkimin në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme;
- Akuakultura;
- Tregtimin dhe përpunimin e peshkut.

Brenda aparatit të MBZHR-së për vitin 2016 struktura e identifikuar si përgjegjëse për sektorin e peshkimit dhe të akuakulturës është Drejtoria e Peshkimit me dy sektorë në përbërje të saj. Sektori i Politikave të Peshkimit dhe Sektori i Politikave të Akuakulturës dhe Ujërave të Brendshme. Bazuar në Rregulloren e Brendshme të MBZHR-së miratuar më datë 10.02.2017 me nr. 10260/2 prot.

Sektori i Politikave të Peshkimit ka si detyra dhe përgjegjësi:

- Propozon ndryshime në akte ligjore dhe nënligjore dhe ndjek përafrimin e legjislacionit me atë rajonal dhe të BE-së;
- Nxiti peshkimin dhe akuakulturën drejt aktiviteteve komerciale me qëllim që të rriten të ardhurat vendase dhe të reduktohet sasia e peshkut të importuar;

¹⁰Rregullore e Brendshme e Veprimtarisë dhe Funkcionimit të MBZHR-së, miratuar më 10.02.2017.

- Grumbullon dhe përpunon informacionin lidhur me tregjet, sasinë e peshkut të zënë, import-eksportet;
- Monitoron implementimin e standardeve të sigurisë ushqimore në bashkëpunim me autoritetet kompetente;
- Kontrollon zbatimin e legjislacionit në fushën e sigurisë ushqimore për produktet ujore;
- Komunikon dhe bashkëpunon me AKU dhe ISUV;

Sektori i Politikave të Akuakulturës dhe Ujërave të Brendshme ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Harton politikat e zhvillimit të sektorit të Peshkimit dhe Akuakulturës;
- Përditësimin e akteve ligjore dhe nënligjore për peshkimin dhe akuakulturën;
- Grumbullon informacion dhe të dhëna si dhe përgatit të dhëna statistikore për peshkimin dhe gjendjen e tij;
- Drejton dhe bashkërendon punën për realizimin e sistemit të monitorimit dhe kontrollit;
- Menaxhon Planet e Monitorimit të Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit;

Struktura e MBZHR-së ka ndryshuar në vitin 2017 duke shkrirë Drejtorinë e Peshkimit dhe duke krijuar dy sektorë - *Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës* si pjesë e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe - *Sektori i Programeve të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës* si pjesë e Drejtorisë së Programeve të zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural¹¹. Detyrat kryesore të Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës, kanë të bëjnë me hartimin e politikave dhe strategjive sektoriale në funksion të zhvillimit të peshkimit dhe akuakulturës në përputhje me programin qeveritar dhe Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE-së, organizmave ndërkombëtare ku vendi ynë aderon dhe kontribuon. Sektori i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës ka funksion identifikimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të programeve të zhvillimit të peshkimit dhe akuakulturës në përputhje me politikat dhe strategjinë e zhvillimit të këtij sektori.

Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës është krijuar me Ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, neni 66, VKM nr. 719, datë 20.10.2011 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit Sarandë” e ndryshuar¹². Me urdhrin nr. 96, datë 21.02.2014 “Për miratimin e Strukturës dhe organikës së DSHPA-së është bërë pjesë e saj edhe “Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit”.

¹¹Urdhër nr. 168, datë 05.10.2017 Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së MBZHR-së”, i ndryshuar

Urdhër 520 datë 1.12.2017 “Për miratimin e Strukturës së MBZHR-së”

¹² VKM nr. 719, datë 20.10.2011 ndryshuar me VKM nr. 1068, datë 14.12.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 719, date 20.10.2011 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit Sarandë” ku ma marrë emërtimin Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, më pas është ndryshuar me VKM nr. 44, datë 29.01.2014 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 719, datë 20.10.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”, të ndryshuar”.

Bazuar në VKM nr 44. datë 29.01.2014 Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës ka për mision përmbushjen e të gjitha shërbimeve të nevojshme shtetërore që lidhen me menaxhimin e infrastrukturës dhe të dhënave të peshkimit e të akuakulturës, si dhe garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në mbrojtjen e peshkimit dhe akuakulturës në Republikën e Shqipërisë.

Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës kryen këto detyra¹³:

- Menaxhon infrastrukturën e peshkimit, përfshirë portet dhe qendrat e peshkimit;
- Grumbullon të dhënat e peshkimit;
- Harton programet e ripopullimit të kategorive ujore;
- Menaxhon qendrën dhe impiantet e midhjes në Sarandë;
- Menaxhon ekonomitë e rasateve të peshkut në Zvezdë - Korçë, të rasateve të koranit në Lin - Pogradec, dhe ekonomitë e tjera të rasateve të peshkut;
- Garanton respektimin e kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së peshkimit dhe akuakulturës nëpërmjet monitorimit dhe inspektimit të veprimtarisë së peshkimit.

Monitorimi dhe inspektimi i veprimtarisë së peshkimit kryhen nga sektori i monitorimit dhe i kontrollit të peshkimit, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës".

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare është një institucion ndër dikasterial që ka për detyrë të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizimin, planëzimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar. Si një nga institucionet pjesëmarrëse në QNOD Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka kapacitet bashkërendues. QNOD garanton menaxhimin dhe kontrollin e kufijve detarë shqiptarë, sigurinë e jetës në det dhe ndërveprimin e institucioneve shtetërore që kanë përgjegjësi dhe interesa në hapësirën detare.


QNOD është institucion kombëtar që garanton ushtrimin e sovranitetit dhe të drejtave sovrane të shtetit shqiptar në hapësirën detare nëpërmjet menaxhimit të integruar të burimeve kombëtare të institucioneve që kanë përgjegjësi dhe interesa në det.

Detyra e QNOD-së që lidhet me temën objekt auditimi është bashkëpunimi me Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit për:

- Operacionet në mbrojtje të peshkimit
- Operacionet për mbrojtjen dhe mirë administrimin e pasurisë peshkimore (biomasa ihtiologjike)
- Operacionet për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe mjedisit detar.

¹³VKM nr 44. datë 29.01.2014 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 719, datë 20.10.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës", të ndryshuar".

Figura 2: Dobësitë/problematikat me të cilat përballlet sektori i peshkimit dhe akuakulturës¹⁴.



Pavarësisht se ky sektor është një sektor që ka plot problematika të identifikuar ai gjithashtu ka dhe një potencial të madh ndikimi në zhvillimin social – ekonomik të zonave përkatëse, por kontributi që aktiviteti i peshkimit dhe akuakulturës jep në ekonominë vendase është relativisht i ulët, p.sh 0.3 % e GDP për vitin 2017¹⁵.

Për periudhën objekt auditimi 2016-2018 zënia e peshkut sipas kategorive është¹⁶:

Tabela 1: Zënia e peshkut sipas kategorive 2016-2018

NR	EMËRTIMI	2016	2017	2018
1	Detar	4646	4609	6202
2	Bregdetar	952	1074	90.2
3	Laguna	598	599	90.4
4	Ujërat e brendshme	1688	2007	2427
5	Akuakultura	3200	4000	5138
6	Molosqe	1450	430	1108
	Total në ton	12534	12719	15055.6

¹⁴Figura 2 është përgatitur nga grupi i auditimit dhe informacioni është gjeneruar nga SKP 2016-2021

¹⁵ EUROFISH –International Organization <https://www.eurofish.dk/albania>

¹⁶Burimi DSHPA

1.4.2. Politikat e institucionit/agjencisë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka për qëllim konceptimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Misioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është zbatimi i programit të qeverisë në fushën e veprimtarisë së saj dhe ndër të tjera në hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, hartimin dhe përafrimin e legjislacionit në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit rural në koherencë të plotë me kërkesat e BE-së.

Duke filluar që nga viti 2016, vit kur është miratuar edhe Strategjia Kombëtare e Peshkimit MBZHR është angazhuar në realizimin e objektivave të mëposhtëm¹⁷:

- Forcimi i kapacitetit institucional të MBZHR-së për të administruar me efektivitet sektorin e Peshkimit dhe Akuakulturës;
- Ngritja e një sistemi transparent të besueshëm dhe të qëndrueshëm të bashkë menaxhimit mes administratës, OPM-ve, dhe palëve të tjera të interesit në përputhje me kuadrin ligjor;
- Përafrimi i menaxhimit, kontrollit, tregtimit, politikës strukturore, procedurës së planifikimit dhe legjislacionit të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës me komponentët përkatës të Acquis të peshkimit;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve tregtare detare nëpërmjet një kontrolli efektiv dhe mbështetjes tek shkenca e saktë;
- Mirë menaxhimi i mjedisit detar duke mbështetur një sektor peshkimi artizanal të qëndrueshëm;
- Menaxhimi i peshkimit në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme bazohet në një njohje të mirë të rezervave, sforcos së peshkimit dhe nevojave të personave që mbështeten te ky peshkim për të siguruar jetesën;
- Një sistem menaxhimi dhe detyrimi për zbatim të ligjit i cili kontrollon qasjen ndaj rezervave peshkore në mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme;
- Zhvillimi i sektorit të akuakulturës përmes një përafrimi të planifikimit strategjik gjithëpërfshirës dhe të bazuar tek ekosistemi, planifikim i cili rishikohet dhe përditësohet periodikisht;
- Lehtësimi i investimeve në akuakulturë përmes identifikimit të zonave të përcaktuara për akuakulturë si pjesë e planit hapsinor ndër sektorial detar dhe të ujërave të brendshme;
- Krijimi i sinergjive mes programeve kërkimore kombëtare dhe bashkëpunim mes industrisë dhe komunitetit shkencor;
- Përmirësimi dhe mbështetja e kushteve të higjenës dhe shëndetit të publikut;
- Rritja e transparencës dhe forcimi i menaxhimit të tregut;

Në perspektivën e zhvillimit të sektorit të peshkimit MBZHR ka marrë dhe do të marrë një sërë nismash të cilat do të sjellin një zhvillim të mëtejshëm të këtij sektori. Disa nga nismat janë¹⁸:

- Nëpërmjet programit IPA, i cili do të japë 50 % mbështetje për ndërrimin e motorëve të anijeve të peshkimit, për gjithë frigoriferët në anijet e peshkimit dhe për të gjithë pjesën elektronike në të gjithë flotën tonë të peshkimit;

¹⁷Strategjia Kombëtare e Peshkimit 2016-2021

¹⁸ <https://www.kryeministria.al/newsroom/sektori-i-peshkimit-ne-tre-vjet-mbi-pesefishim-i-eksporteve/>

- Modernizimi i kushteve të tregtimit të peshkut, i konceptuar në ndërtimin e një rrjeti markatosh të standardeve bashkëkohore;
- AZHBR do të japë mbështetje për ndërtimin e vend ankorimit të anijeve të vogla, si dhe ndërtimin e pikave të grumbullimit dhe atyre frigoriferike;
- Mbështetje me 70 % të vlerës për ndërtimin e bankinave, në të cilat mund të ankorojnë anijet e vogla;
- Investime në pika grumbullimi dhe në pika frigoriferike;

1.4.3 Pesha në buxhet

Për periudhën objekt auditimi, fondet buxhetore për subjektin nën auditim paraqiten si më poshtë:


Tabela 2: Buxheti total i MBZHR-së kundrejt programit "Mbështetje për peshkimin"

000/lekë

Emërtimi Buxhetor	2016		2017		2018	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
I. Programi "Mbështetje për Peshkimin"	363,500	362,045	114,350	93,693	231,892	171,618
II. MBZHR Total	11,157,376	10,876,322	8,028,203	7,639,965	23,203,350	17,175,970
I/II	3.26%	3.33%	1.42%	1.23%	1%	1%

Burimi: MBZHR – Punoi:Grupi i auditimit

Grafiku 1: Programi "Mbështetje për peshkimin kundrejt buxhetit total të MBZHR-së"



Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 2 buxheti që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka dhënë për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës ka ardhur duke u ulur që nga viti 2016 në vitin 2017 dhe akoma më shumë në vitin 2018. Përkatësisht në vitin 2016 për sektorin e peshkimit është planifikuar nëpërmjet programit "Mbështetje për peshkimin" 3.26% e buxhetit dhe është realizuar 3.33%, për vitin 2017 është planifikuar 1.42% e buxhetit dhe është realizuar 1.23% pra 2.1% më pak në realizim se në vitin 2016, ndërsa për vitin 2018 është planifikuar 1% dhe po 1% është realizuar, pra 2.3% më pak se në vitin 2016.


Tabela 3: Programi "Mbështetje për peshkimin sipas zërave"

000/lekë


	Viti 2016			Viti 2017			Viti 2018		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Shpenzime per fond pagash	30,500	30,283	8.4%	43,250	42,930	45.8%	46,700	46,328	27.2%
Shpenzime operative	55,580	54,966	15.2%	50,000	49,816	53.2%	52,500	52,105	30.6%
Investime te Brendshme	77,420	77,198	21.3%	21,100	947	1%	61,542	9,948	5.8%
Investime te Huaja	200,000	199,598	55.1%	0	0	0%	71,150	61,727	36.3%
Totali	363,500	362,045		114,350	93,693		231,892	170,108	

Burimi MBZHR - Punoi grupi i auditimit


Grafiku 2: Programi "Mbështetje për peshkimin 2016-2018"



PROGRAMI "MBËSHTETJE PËR PESHKIMIN " VITI 2016



PROGRAMI "MBËSHTETJE PËR PESHKIMIN " VITI 2017






Tabela 4: Investimet e kryera sipas zërave në kuadër të programit "Mbështetje për peshkimin"
Burimi MBZHR – përpunoi grupi i auditimit

Emërtimi Buxhetor	2016		2017		2018	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Programi "Mbështetje për Peshkimin"						
Investime të Brendshme	77,420	77,198	21,100	947	61,542	9,948
Bashkëfinancim me K.L e TVSH për Projektin e Portit të ri të peshkimit Durrës	77,420	77,198				
Ngritja e sistemit VMS (Instalimi i transponderave) për anijet e peshkimit			20,000	0		
Hartimi i projektit të zbatimit për " Ndërtimi i tregut të shitjes me shumicë të peshkut në Shëngjin "			960	828		
Hartimi i projektit të zbatimit për " Thëllimi i kanalit Bistricë "			140	119		
Ndërtimi i Tregut të peshkut Shëngjin					50,042	5,155
"Pajisje Laboratorike" për QGDMS dhe Ekonomitë e rritjes së rasateve					5,000	4,793
"Blerje të bankinave të lëvizshme" për Portet e Peshkimit					6,500	0
Investime të Huaja	200,000	199,598	0	0	71,150	61,727
Dokumenti Sektorial për Peshkimin (IPA II)			0	0	71,150	63,237
Projekti për Portin e ri të peshkimit në Durrës	200,000	199,598				
Total Investime (I+II)	277,420	276,796	21,100	947	132,692	73,185
I. MBZHR shp Kapitale	277,420	276,796	0	0	121,192	68,392
II. DSHPA shp Kapitale	0	0	21,100	947	11,500	4,793

Siç mund të vërehet nga tabela nr.4:

Për vitin 2016 janë parashikuar 77,420,000 lekë investime të brendshme dhe janë realizuar 77,198,000 lekë pra në masën 97%. Ky investim është kryer për projektin e portit të ri të peshkimit në Durrës. Investime të huaja janë parashikuar 200,000,000 lekë dhe janë realizuar 199,598,000 lekë, pra në masën 100%. I gjithë investimi i huaj ka shkuar për ndërtimin e portit të ri të peshkimit Durrës.

Për vitin 2017 janë parashikuar 21,100,000 lekë investime për sektorin e peshkimit, përkatësisht për zërat "Ngritjen e sistemit VMS; hartimin e projektit të zbatimit për ndërtimin e tregut të shitjes me shumicë të peshkut në Shëngjin dhe hartimin e

projektit të zbatimit për thellimin e kanalit Bistricë”. Këto parashikime në investime janë realizuar vetëm në shumën 947,000 lekë ose afërsisht 4.5% e vlerës totale. Për vitin 2017 nuk ka pasur të parashikuara investime të huaja.

Për vitin 2018 janë parashikuar 61,542,000 lekë investime të brendshme dhe janë realizuar 9,948,000 lekë ose në masën 16% e vlerës totale. Këto fonde investimesh janë dhënë për ndërtimin e tregut të peshkut Shëngjin dhe për blerjen e pajisjeve laboratorike për QGDMS, ndërsa vlera prej 6500,000 lekë e planifikuar për blerjen e bankinave të lëvizshme për portet e peshkimit nuk është shpenzuar. Pra kemi të bëjmë me një investim të pa kryer nga ana e MBZHR-së. Investimet e huaja të planifikuara kanë qenë 71,15,000 lekë dhe janë realizuar në shumën 61,727,000 lekë ose në masën 87% të vlerës totale.

Për vitin 2016 investimet e parashikuara janë realizuar në masën 100%; për vitin 2017 investimet e parashikuara janë realizuar në masën 4.5 % dhe për vitin 2018 investimet e parashikuara janë realizuar në masën 55%.

Ajo që mund të vihet re nga analizimi i të dhënave për buxhetin që i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit është se: programi “Mbështetje për peshkimin” për periudhën objekt auditimi 2016-2018 ka ardhur duke u ulur nga 3.33% në vitin 2016, në 1.23% në vitin 2017 dhe në 1% në vitin 2018. Nga detajimi i bërë zërave të buxhetit rezulton se:

Viti 2016 –nga programi “Mbështetje për peshkimin”,8.4% e buxhetit ka shkuar për paga, 15.2% për shpenzime operative, 21.3% investime të brendshme dhe 55.1% investime të huaja. Në vitin 2016 i gjithë zëri investime të brendshme dhe të jashtme ka shkuar për ndërtimin e portit të ri të peshkimit në Durrës.

Viti 2017 – nga programi “Mbështetje për peshkimin”, 45.8% e buxhetit ka shkuar për paga, 53.2% për shpenzime operative dhe 1% për investime të brendshme të cilat kanë shkuar për hartimin e projekteve të ndërtimit të tregut të peshkut Shëngjin dhe thellimin e kanalit Bistricë. Investime të huaja nuk ka.

Viti 2018 – nga programi “Mbështetje për peshkimin”, 27.2% e buxhetit ka shkuar për paga, 30.6% për shpenzime operative, 5.8% investime të brendshme dhe 36.3% investime të huaja. Në vitin 2018, 52% e investimeve të brendshme ka shkuar për ndërtimin e tregut të peshkut Shëngjin dhe 48% për blerjen e pajisjeve laboratorike për QGDMS. Gjithashtu nga sa vërehet në tabelën e mësipërme në vitin 2018, 10.5% e buxhetit të planifikuar do të shkonte për blerje të bankinave të lëvizshme për portet e peshkimit, zë ky i pa realizuar.

Tabela 5: Përmbledhje e buxhetit të MBZHR-së për peshkimin dhe akuakulturën, 2016-2018

Emërtimi	Viti 2016		Viti 2017		Viti 2018	
	Plan përfundimtar	Fakt	Plan përfundimtar	Fakt	Plan përfundimtar	Fakt
I. MBZHR shp Korrente	20,000	19,518	4,500	4,337	5,200	5,200
II. DSHPA shp Korrente	66,080	65,731	88,750	88,409	94,000	93,233
III. Programi Mbështetje për Peshkimin	363,500	362,045	114,350	93,693	231,892	170,108
III-a. Shpenzime për fond pagash DSHPA	30,500	30,283	43,250	42,930	46,700	46,328
III-b. Shpenzime operative	55,580	54,966	50,000	49,816	52,500	52,105
III-c. Investime të Brendshme	77,420	77,198	21,100	947	61,542	9,948

Bashkëfinancim me K.L e TVSH për Projektin e Portit të ri të peshkimit në Durrës	77,420	77,198				
Ngritja e sistemit VMS (Instalimi i transponderave) për anijet e peshkimit			20,000	0		
Hartimi i projektit të zbatimit për "Ndërtimi i tregut të shitjes me shumicë të peshkut në Shëngjin"			960	828		
Hartimi i projektit të zbatimit për "Thellimi i kanalit Bistricë"			140	119		
Ndërtimi i Tregut të peshkut Shëngjin					50,042	5,155
"Paisje Laboratorike" për Qendrën e Grumbullimit dhe Depurimit të Midhjes dhe Ekonomitë e rritjes së rasateve					5,000	4,793
"Blerje të bankinave të lëvizshme" për Portet e Peshkimit					6,500	0
III-d. Investime të Huaja	200,000	199,598	0	0	71,150	61,727
Dokumenti Sektorial për Peshkimin (IPA II)			0	0	71,150	63,237
Projekti për Portin e ri të peshkimit në Durrës	200,000	199,598				
Total Investime	277,420	276,796	21,100	947	132,692	73,185
I. MBZHR shp Kapitale	277,420	276,796	0	0	121,192	68,392
II. DSHPA shp Kapitale	0	0	21,100	947	11,500	4,793
TOTAL PROGRAMI	363,500	362,045	114,350	93,693	231,892	171,618
MBZHR TOT	11,157,376	10,876,322	8,028,203	7,639,965	23,203,350	17,175,970

Burimi MBZHR, përpunoi grupi i auditimit

1.4.4. Risqet e aktiviteteve të subjekteve

Risqet e aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që institucionet hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Në tabelën nr. 5 më poshtë janë renditur risqet sipas fushës së aktivitetit. Janë marrë në konsideratë vetëm risqet e nivelit mesatar dhe të lartë, si dhe kemi analizuar ndikimin që kanë risqet e identifikuar në aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës. Risqet janë identifikuar të lidhura me pyetjet e auditimit si dhe është vlerësuar niveli i vështirësisë që mund të ketë subjekti në tejkalimin e tyre.

Tabela 6: Analiza e Riskut¹⁹

Fusha e aktivitetit	Përshkrimi i Riskut	Ndikimi që mund të kenë risqet e identifikuar	Niveli i Riskut ²⁰	Prefixa e Auditimit	Lidhja dhe Realizuesh mëria ²¹
Ngritja, organizimi dhe bashkërendimi i strukturave përgjegjëse apo me ndikim	Strukturat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Peshkimit dhe në legjislacionin përkatës përgjegjëse për menaxhimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës mund të mos jenë ngritur apo mund të mos bashkërendojnë punën midis tyre	Menaxhim jo efektiv i aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës; Kushte të papërshtatshme për ushtrimin e aktivitetit nga peshkatarët;	L	A janë ngritur dhe a bashkëpunojnë si duhet strukturat që kanë përgjegjësi apo janë të përfshira në menaxhimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës?	L E vështirë
	Mbështetja e dhënë nga MBZHR në drejtim të peshkimit dhe akuakulturës	Sektori i peshkimit dhe akuakulturës mund të mos ketë marrë mbështetjen e duhur nga MBZHR	Ushtrimin e aktivitetit nga peshkatarët;	L	Cilat kanë qenë fushat e ndërhyrjeve strukturore që MBZHR ka dhënë mbështetje në drejtim të peshkimit dhe akuakulturës?
Kuatrë ligjor, administrativ dhe institucional që rregullojnë aktivitetin e subjekteve	Kuatrë ligjor mund të mos jetë i plotë dhe i përditësuar, mund të mos jenë miratuar aktet nënligjore dhe rregullative përkatëse	Rritje e peshkimit të paligjshëm; Dëmtim i mjedisit detar;	M	A janë miratuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës?	M Normale L
	Niveli i zbatimit të legjislacionit mund të jetë i dobët	Shfrytëzim i hapësirave të porteve për qëllime të tjera;	L		Normale
Burimet Njerëzore	Strukturat përgjegjëse mund të kenë mungesë të stafit të nevojshëm për të kryer detyrat e tyre funksionale	Ujje e të ardhura nga aktiviteti i peshkimit;	M	A ka MBZHR burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme për të përmbyshur detyrat që i ngarkon legjislacioni përkatës?	M L E vështirë
	Buxheti në mbështetje të aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës mund të mos jetë ai i duhuri	Mos përmirësim i kushteve social-ekonomike të komunitetit të peshkatarëve.	M		M Normale
	Institucioni mund të ketë mungesa në mjete logjistike për të kryer inspekte				L
	OMP mund të mos zbatojnë nenet e marrëveshjes së nënshkruar me MBZHR-në				A është efektiv menaxhimi i porteve nga OMP-të krahasuar me menaxhimin nga DSHPA, dhe a zbatohet marrëveshja e nënshkruar me MBZHR-në për këtë menaxhim?
Zbatimi i marrëveshjeve dy-palëshe dhe i detyrimeve ligjore si dhe kushtet e punës	Marrëveshja për transferimin në përdorim të porteve tek OMP mund të ketë mangësi MBZHR mund të mos ketë realizuar mbikëqyrjen e duhur në zbatimin e marrëveshjeve MBZHR mund të mos ketë buxhetin e mjaftueshëm për të realizuar investimet që nevojiten apo për të plotësuar nevojat sipas rëndësisë				M Normale E vështirë

¹⁹Analiza e riskut është kryer nga grupi i auditimit bazuar në modelin e analizës së riskut të ECA-s.

²⁰L-risku i lartë, M-risku mesatar, grupi i auditimit ka marrë në konsideratë vetëm nivelin e lartë dhe mesatar të riskut.

²¹Shkalla e lidhjes së riskut me aktivitetet dhe vështirësitë e subjektit në tejkalimin e riskut. L-e lartë, M-mesatare.

1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit

I gjithë aktiviteti i MBZHR-së dhe i DSHPA-së si institucion në varësi të saj përkthehet në një numër produktesh që duhet të marrë komuniteti i peshkimit. Përgjithësisht këto produkte janë të lidhura me:

- Përditësimin e akteve ligjore dhe nënligjore;
- Hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre;
- Hartimin e strategjive dhe planeve të veprimit për veprimtarinë e peshkimit dhe akuakulturës;
- Mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit detar/ujërave të ëmbla/ ujërave të brendshme në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Përmirësimin e kushteve të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës;
- Zhvillimi social - ekonomik i zonave ku aktiviteti i peshkimit është ndikues dhe i rëndësishëm.

Përkatësisht produktet e sipër përmendura të subjektit janë baza për komunitetin e peshkimit që aktiviteti i peshkimit dhe akuakulturës të jetë në mbështetje të tyre dhe të sjellë zhvillim social - ekonomik të zonave përkatëse duke rritur sasinë e zënieve dhe kështu duke krijuar vende pune.

Menaxhimi në mënyrë efektive i porteve të peshkimit nga ana e MBZHR/DSHPA në bashkëpunim me OMP vjen në ndihmë të peshkatarëve duke bërë të mundur që ato të kenë hapësirat e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të tyre, të kenë kushtet e nevojshme për riparimin e anijeve/varkave të peshkimit, t'u sigurohet infrastruktura e nevojshme për shitjen e produkteve të tyre.

Mbulimi i të gjithë vendit dhe i të gjithë zinxhirit të aktivitetit të peshkimit me vëzhgim, monitorim, kontroll dhe inspektim është e rëndësishme për të ulur aktivitetin e paligjshëm, ruajtjen e mjedisit ujor të vendit, ruajtjen e rezervave të peshkimit si dhe ofrimi i sigurisë për konsumatorin.

1.4.6 Feedback-u i subjektit në fazën e terrenit

Gjatë fazës së terrenit bashkëpunimi i subjekteve që janë nën auditim ka qenë pozitiv dhe i kënaqshëm. Për sa i përket bashkëpunimit për vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e auditimit bashkëpunimi me grupin e auditimit ka rezultuar si më poshtë:

Subjekti MBZHR dhe DSHPA, i janë përgjigjur brenda afateve grupit të auditimit lidhur me përgjigjen e pyetësorëve, vënien në dispozicion të dokumentave që ato dispononin. Në intervistat e zhvilluara dhe në takimet për sqarime lidhur me problematikat e çështjeve nën auditim punonjësit e sektorëve përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën në MBZHR dhe punonjësit e DSHPA janë treguar korrekt dhe bashkëpunues me grupin e auditimit. Bashkëpunimi në këtë fazë të auditimit është një bashkëpunim i saktë, korrekt, në kohë dhe me përgjegjshmëri profesionale.

2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT

Gjatë fazës së terrenit grupi i auditimit ka grumbulluar dokumente mbi temën objekt auditimi, të dhëna për periudhën 2016-2018 si dhe ka realizuar intervista me punonjës të ndryshëm që mbulojnë hallka të ndryshme të procesit të peshkimit dhe akuakulturës. Gjithashtu për të marrë informacion më të detajuar u zhvilluan pyetësorë me strukturat e MBZHR-së dhe DSHPA-së të cilët u morën në shqyrtim dhe u analizuan nga grupi i auditimit. Në fazën e kryerjes së auditimit bazuar në dokumentacionin e mbledhur dhe analizuar qasja audituese që u aplikua ishte – qasja pragmatike. Kjo qasje si një qasje mikse e qasjes sasiore dhe cilësore u përdor për të analizuar problemet e konstatuara nga grupi i auditimit për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës. Grupi pasi analizoi evidencat e grumbulluara i krahasoi ato kundrejt kritereve të paravendosura për të arritur kështu në përfundimet përkatëse dhe të bazuara në evidencat e auditimit.

2.1 Objektivi dhe problemi

Auditimi i performancës me temë “Performanca e MBZHR-së në kuadër të zbatimit të politikave të peshkimit dhe akuakulturës” paraqet një tablo të qartë dhe të plotë të situatës në të cilën ndodhet peshkimi dhe akuakultura në vendin tonë. Nëpërmjet këtij auditimi u analizua performanca e strukturave të MBZHR-së dhe institucionit në varësi (DSHPA) për sa i takon zbatimit të politikave dhe realizimit të objektivave strategjike për peshkimin dhe akuakulturën. Ky auditim u fokusua në nivelin makro duke marrë në shqyrtim dhe analizim bazën ligjore dhe rregullatore të subjekteve dhe në nivel mikro përsa i takon zbatimit të kuadrit rregullator dhe realizimit të objektivave specifike të zhvillimit të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës.


Grupi i auditimit mori në shqyrtim dhe analizoi aktivitetin e aktorëve kryesorë dhe të përfshirë në menaxhimin e këtij sektori dhe si objektivi kryesor të auditimit kishte efektivitetin në menaxhimin dhe zbatimin e politikave për peshkimin dhe akuakulturën.

2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit

Në kryerjen e auditimit mbi aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës gjatë fazës së terrenit grupi i auditimit identifikoi disa probleme të cilat ishin në fokus të këtij auditimi:

- Shkalla e zbatimit të objektivave strategjike të vendosura në Strategjinë Kombëtare të Peshkimit 2016-2021;
- Miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të SKP, pra në miratimin e gjithë kuadrit rregullator përfshirë këtu edhe rregullore apo urdhra të ndryshëm;
- Funksionimi i strukturave në zbatim të SKP dhe legjislacionin për peshkimin;
- Vëzhgimi, monitorimi, kontrolli dhe inspektimi i aktivitetit të peshkimit;
- Menaxhimi i porteve të peshkimit, ku grupi i auditimit do të ketë në fokus analizimin dhe krahasimin e dy mënyrave të menaxhimit të porteve të peshkimit në vendin tonë;
- Burimet njerëzore dhe mjetet logjistike në dispozicion të tyre për përmbushjen e detyrave funksionale.

Fig.3 Modeli Input-Output



2.1.2. Objektivi i auditimit

Sektori i peshkimit dhe akuakulturës është një aktivitet i gjerë. Ai përfshin dhe ka ndikim në një sërë elementesh siç janë: - Mbrojtja e mjedisit; - Zhvillimi social - ekonomik i zonave ku ushtrohet aktiviteti apo produkte të sigurta për konsumatorët. Gjatë kryerjes së këtij auditimi grupi i auditimit kishte si objektiv (të jepte një vlerësim të përgjithshëm mbi përmbushjen e Objektivave Specifike të Zhvillimit të vendosura në Strategjinë Kombëtare të Peshkimit 2016-2021, të vlerësonte zbatimin e legjislacionit për peshkimin dhe akuakulturën, të analizonte procesin e monitorimit-kontrollit-vëzhgimit-inspektimit të aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës si dhe të pasqyronte gjendjen në të cilën ndodhet infrastruktura e peshkimit dhe akuakulturës. Duke pasur në vëmendje objektivat e sipërcituar grupi i auditimit hartoi piramidën e pyetjeve audituese e cila nëpërmjet nën pyetjeve të nivelit të parë dhe të dytë synon të mbulojë aktivitetin e peshkimit dhe të akuakulturës. Në këtë mënyrë, nëpërmjet këtij auditimi grupi i auditimit realizoi shqyrtimin dhe analizimin e evidencave në dispozicion për të evidentuar problematikat kryesore të këtij sektori dhe ndikimin që ato kanë në komunitetin përkatës.

2.2 Përkufizimet dhe terminologjia

- “Aktivitet peshkimi” janë veprimtaritë e lidhura me kërkimin e peshkut, me lëshimin, vendosjen dhe tërheqjen e mjeteve të peshkimit, transferimin në bord të zënieve, trasbordimin, ruajtjen në bord, transformimin në bord, transferimin, vendosjen në kosha, majmërinë dhe shkarkimin e peshqve dhe produkteve të peshkimit.
- “Akuakulturë” është kultivimi ose mbarështimi i organizmave ujore si peshqit, molusqet, krustacetë dhe bimët ujore nga personat fizikë ose juridikë, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përcaktuara për të rritur prodhimin e tyre përtej kapaciteteve natyrore në mjedis, ndërhyrjes në ciklin e tyre të plotë apo të pjesshëm, në një pjesë të përzgjedhur dhe të kontrolluar të territorit ujor dhe tokësor në Republikën e Shqipërisë;
- “Anije peshkimi” është mjeti lundrues i çfarëdolloj madhësie që përdoret apo që synohet të përdoret për shfrytëzimin e burimeve peshkore për qëllime tregtare, përfshirë anijet mbështetëse, anijet përpunuese të peshkut, anijet e përfshira në transbordim dhe anijet transportuese të pajisura për transportimin e produkteve peshkore, përjashtuar anijet e kontejnerëve.
- “Autoritete përgjegjëse” janë autoritetet e ngarkuara nga ky ligj ose nga ligje të veçanta që përcaktojnë fushën e tyre të veprimtarisë, për të kontrolluar hallka të caktuara të aktivitetit të peshkimit.
- “Autorizimi për peshkim” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri për subjektin që aplikon për ushtrim aktiviteti peshkimi, gjatë një periudhe të caktuar, për qëllime të kërkimit shkencor, si dhe për zona peshkimi dhe specie objekt kufizimesh ligjore apo nënligjore.
- “Biodiversitet” është kuptimi i dhënë në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
- “Drejtoria e peshkimit” është drejtoria përgjegjëse për zbatimin e politikave të peshkimit pranë ministrisë.

- “Ekosistem detar/ujor” është një kompleks dinamik, i përbërë nga komunitete të bimëve, kafshëve e mikroorganizmave, si dhe mjedisi jo i gjallë, të cilat ndërveprojnë ndërmjet tyre si një njësi funksionale.
- “Flotë peshkimi” është numri i përgjithshëm i anijeve të peshkimit me flamur shqiptar, të regjistruara në regjistrin kombëtar të mjeteve të peshkimit.
- “Inspektim” është çdo kontroll i kryer nga nëpunësit përkatës për të verifikuar zbatimin e rregullave të peshkimit dhe pasqyrimin e këtij kontrolli në raportin përkatës.
- “Leje peshkimi” është dokumenti zyrtar që i jep të drejtën mbajtësit të saj të ushtrisë aktivitet peshkimi dhe të përdorë një sasi të caktuar të peshkut dhe produkteve të tij për shfrytëzim tregtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- “Libri i anijes së peshkimit” është një dokument regjistrimi i aktivitetit të përditshëm të peshkimit.
- “Mbikëqyrje” është inspektimi i aktiviteteve të peshkimit me anije patrulluese, me mjete ajrore dhe mjete të tjera për të vëzhguar zbatimin e përcaktimeve të këtij ligji.
- “Mbi shfrytëzim (mbi peshkim)” është situata kur presioni i ushtruar nga aktivitetet e peshkimit tejkalon limitin e peshkimit.
- “Menaxhim i peshkimit” është procesi i integruar i mbledhjes së informacionit, analizimit, planifikimit, konsultimit, vendimmarrjes, shpërndarjes së burimeve, formulimit dhe zbatimit (me detyrim nëse është e nevojshme) të rregullave të aktivitetit të peshkimit, në mënyrë që të sigurohet produktiviteti i vazhdueshëm i burimeve dhe përmbushja e objektivave të tjerë të peshkimit.
- “Mjedis uJOR” janë komponentët fizikë, kimikë, gjeologjikë dhe biologjikë, kushtet dhe faktorët, të cilët ndërveprojnë dhe përcaktojnë prodhimtarinë, stadin, kushtet dhe cilësinë e ekosistemit uJOR, të ujërave dhe hapësirës ajrore mbi këto ujëra, si dhe të shtratit të detit e shtresave të tyre.
- “Organizma uJORë” janë organizmat e gjallë ose jo, shtazorë a bimorë, të ngrënëshëm a të pangrënëshëm, që kanë ujin si mjedis të zakonshëm ose natyror jetese, ku përfshihen peshqit, krustacetë, molusqet, koralet, sfungjerët, amfibët, reptilët uJORë, gjitarët uJORë, si dhe vezët, larvat e rasatet e tyre ose prodhime të tjera natyrore, me përjashtim të shpendëve.
- “Organizata rajonale e menaxhimit të peshkimit” janë organizmat ndërkombëtarë të krijuar nga shtete me interesa të përbashkët për peshkimin.
- “Peshkim i paligjshëm, i parregulluar dhe i pa raportuar (PPP)” janë aktivitetet e peshkimit që janë të paligjshme, të parregulluara apo të pa raportuara, kuptimet e të cilave jepen me hollësi më poshtë:
 - a) “Peshkim i paligjshëm” është aktiviteti i peshkimit që kryhet:
 - i) nga një anije peshkimi, vendase apo e huaj, në ujërat detare nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, pa lejen e saj, apo në shkelje të dispozitave ligjore të legjislacionit shqiptar;
 - ii) nga një anije peshkimi që mban flamurin e Republikës së Shqipërisë, por që ushtron aktivitetin në kundërshtim me masat menaxhuese dhe konservuese, të miratuara nga organizata të rëndësishme rajonale të menaxhimit të peshkimit, ku

Shqipëria është palë kontraktuese dhe që ajo ka pranuar, apo me dispozitat e ligjit ndërkombëtar të zbatueshëm, për këtë rast;

iii) nga anijet e peshkimit në shkelje të dispozitave të legjislacionit shqiptar apo ndërkombëtar.

iv) nga individë të paautorizuar dhe të pa pajisur me leje peshkimi në hapësirën detare dhe ujërat e brendshme.

b) "Peshkim i pa raportuar" janë aktivitetet e peshkimit që:

i) nuk janë raportuar apo janë raportuar në mënyrë jo korrekte në autoritetet e rëndësishme kombëtare të peshkimit, në kundërshtim me rregulloret dhe ligjet kombëtare të peshkimit;

ii) janë kryer në zonën e kompetencës së një organizate të rëndësishme rajonale të menaxhimit të peshkimit dhe nuk janë raportuar ose janë raportuar në mënyrë jo korrekte, në kundërshtim me procedurat raportuese të asaj organizate.

c) "Peshkim i parregulluar" janë aktivitetet e peshkimit që:

i) kryhen në zonën e aplikimit të një organizate të rëndësishme rajonale të menaxhimit të peshkimit nga anije peshkimi pa kombësi, nga anije peshkimi që kanë flamurin e një shteti jo anëtar të kësaj organizate apo nga ndonjë njësi tjetër peshkimi, që nuk përputhet apo është në kundërshtim me masat konservuese apo menaxhuese të kësaj organizate;

ii) kryhen në zona ose mbi popullata peshkimi, në lidhje me të cilin nuk ka masa të zbatueshme konservuese ose menaxhuese nga anijet e peshkimit që nuk përputhen me përgjegjësitë e Republikës së Shqipërisë për ruajtjen e burimeve detare të gjalla, sipas ligjit ndërkombëtar.

- "Qendra e monitorimit të peshkimit (QNOD)" është qendra e ngritur dhe e pajisur me hardware dhe software kompjuterikë që mundësojnë marrjen, përpunimin dhe transmetimin e të dhënave.
- "Ujëra të brendshme" janë lagunat bregdetare, liqenet natyrore, liqenet e hidrocentraleve, ujëmbledhësit e bujqësisë, lumenjtë dhe ujëra të tjera të Republikës së Shqipërisë, të ndryshme nga ujërat detare, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për peshkimin.
- "Zonë bashkë menaxhimi" është një zonë e peshkimit, e caktuar sipas këtij ligji, ku një organizatë merr pjesë në menaxhimin e burimeve të peshkimit.
- "Zonë e mbrojtur peshkimi" është një zonë gjeografikisht e përcaktuar e sistemit ujqor, në të cilën të gjitha aktivitetet e peshkimit janë përkohësisht ose në mënyrë të përhershme të ndaluara ose të kufizuara, me qëllim përmirësimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore të gjalla ose mbrojtjen e ekosistemeve ujore.
- "Zonë e Përcaktuar për Akuakulturë (ZPA)" është një sistem planifikimi hapësinor apo zonimi, i kryer në nivel kombëtar; ZPA-ja ka për qëllim të identifikojë një zonë të përcaktuar për akuakulturë, të njohur nga autoritetet e planifikimit hapësinor, që konsiderohet si prioritet për zhvillimin e akuakulturës.

2.3 Kriteret

2.3.1 Kriteret e politikës

- Strategjia Kombëtare e Peshkimit 2016-2021;

2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Artikuj nga media e shkruar dhe elektronike;
- Progres-Raporti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë 2016-2018;

2.3.3 Kriteret teknike


- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- *Ligji nr. 154/2014* "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- *Ligji nr. 64* datë, 31.05.2012 "Për Peshkimin";
- *Ligji nr 103* datë, 20.10.2016 "Për Akuakulturën";
- *Ligji nr. 10433*, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
- *VKM nr. 719*, datë 20.10.2011 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë"
- *VKM nr. 1068*, datë 14.12.2013 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 719, date 20.10.2011 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë";
- *VKM nr. 44*, datë 29.01.2014 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 719, datë 20.10.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës", të ndryshuar";
- *VKM nr. 402*, datë 08.05.2013 "Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det";
- *VKM nr. 407*, datë 08.05.2013 "Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim";
- *VKM nr. 494*, datë 01.07.2016 "Për disa shtesa në Vendimin nr. 407, datë 08.05.2013 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim", të ndryshuar;
- *VKM nr. 151*, datë 13.03.2003 "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të porteve të peshkimit në Vlorë dhe në Sarandë dhe për miratimin e marrëveshjes tip, të kalimit në përdorim të porteve të peshkimit tek Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP)";
- *VKM nr. 301*, datë 10.04.2013 "Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillim shkencor për Strategjinë Kombëtare të Peshkimit";
- *VKM Nr. 302*, datë 10.4.2013 "Për ngritjen e Sistemit të Inspektimit për parandalimin, shkurajimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të pa raportuar (PPP) dhe krijimin e skemës së certifikimit të zënieve në peshkim";
- *Rregullore nr. 1*, datë 07.03.2014 "Për zbatimin e Ligjit nr. 64 datë, 31.05.2012 "Për Peshkimin", e ndryshuar;
- *Rregullore nr. 1*, datë 5.6.2018 "Për Peshkimin e Molusqeve Bivalvore";

- *Rregullore e Brendshme e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës;*
- *Rregullore e Brendshme e MBZHR-së miratuar më datë 10.02.2017 me nr. 10260/2 prot.*
- *Urdhër nr. 42, datë 07.03.2013 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”;*
- *Urdhër nr. 215, datë 05.05.2014 “Për marrjen në ruajtje të Portit të Peshkimit Sarandë”;*
- *Urdhër nr. 339, datë 19.06.2015 “Për marrjen në ruajtje të Portit të Peshkimit Shëngjin, Vlorë”;*
- *Udhëzim Nr. 6, datë 7.5.2018 “Për Përcaktimin e Formave dhe Procedurës së Transferimit të Menaxhimit të Infrastrukturës së Peshkimit”;*
- *Plani i Bashkë menaxhimit të Peshkimit, liqeni i Ohrit, miratuar me shkresën nr. 3911 prot. datë 23.05.2016;*
- *Plani i Bashkë menaxhimit të Peshkimit, liqeni i Shkodrës, miratuar me shkresën nr. 9250prot. datë 06.12.2016;*
- *Marrëveshjet me OMP-të për transferimin në përdorim të portit të peshkimit Durrës dhe Vlorë;*
- *Planet vjetore të punës së DSHPA-së;*
- *Planet tematike vetore;*
- *Analiza vjetore e DSHPA 2016-2018;*
- *Informacione me shkrim mbi: Portet e Peshkimit dhe Programet e Ripopullimit të Kategorive Ujore;*

2.3.4. Kriteret e tjera/Praktikat më të mira

- “Kontrollet mbi peshkimin në BE: duhen bërë përpjekje më të mëdha”, ECA, 2017;
- The State of Mediterranean and Black Sea Fisheries - 2016 ;
- The sustainable development of Mediterranean aquaculture: Problems and perspectives.

2.4 Piramida e pyetjeve audituese



2.5.1 Qasja/metodologjia e auditimit

Në këtë auditim grupi i auditimit është fokusuar në zbatimin e politikave për të përmirësuar gjendjen në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës, konkretisht në përmbushjen e objektivave strategjike dhe zbatimin e detyrimeve ligjore për menaxhimin e këtij aktiviteti dhe si rezultat qasja që do të përdoret do të jetë një përzierje e qasjes sasiore dhe cilësore e orientuar drejt rezultateve.

2.5.2 Metodatat/teknikat audituese

Metodologjia e përdorur në këtë auditim:

- Auditimi përfshiu intervista me nëpunësit përgjegjës për menaxhimin, monitorimin, kontrollin dhe inspektimin në sektorin e peshkimit;
- Shqyrtimi dhe analizimi i dokumenteve, rregulloreve, manualeve, statistikave të grumbulluara, informacionit raportues periodik;
- Shqyrtim i legjislacionit specifik, rregulloreve, raporteve dhe informacionit mbi inspektimin;
- Vizita informuese dhe vizita audituese në terren dhe në strukturat pjesë e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës;
- Intervista dhe pyetësorë më nëpunësit përkatës, peshkatarët apo përfaqësuesit e tyre dhe analizim i përgjigjeve të tyre;
- Shqyrtim dhe analizim i procedurave të brendshme dhe bashkëpunimit midis strukturave përgjegjëse;

2.6 Rezultatet e parashikuara

Kjo temë auditimi dhe çështja që ajo kishte marrë në fokus mendohet të kenë një impakt social të drejtpërdrejtë për komunitetin e peshkatarëve në nivelin mikro dhe një impakt më të gjerë për sa i takon ndikimit që ka aktiviteti i peshkimit dhe akuakulturës në mjedis dhe në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, në konsumatorin e gjerë lidhur me cilësinë e produkteve, dhe ndikimit në ekonominë e vendit përsa i takon potencialeve që ka ky sektor bazuar në karakteristikat gjeografike dhe burimet ujore të vendit tonë.

2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë

Rezultatet e këtij auditimi do të kenë rëndësi për Legjislativin dhe Ekzekutivin për faktin se, nga ky auditim ato do të marrin një panoramë të plotë për problematikat në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës, do të marrin informacion mbi realizimin e objektivave të vendosura në Strategjinë Kombëtare të Peshkimit 2016-2021, mbi zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe e gjitha kjo mund të përkthehet në rritje të vëmendjes ndaj këtij sektori nëpërmjet hartimit të politikave, përditësimit të kuadrit ligjor dhe marrjes së masave direkte për përmirësimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës me qëllim zhvillimin social-ekonomik të komuniteteve përkatëse.

2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit

Ky auditim pritet të sjellë një panoramë të plotë të asaj që po ndodh në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës sot në vendin tonë. Nxjerrja në pah e problematikave dhe sfidave që përballen ky sektor dhe ngritja e tyre në strukturat më të larta ligjvënese

mund të sjellë një përmirësim të dukshëm dhe të prekshëm nga ato që janë palët e interesit në këtë auditim – komuniteti i peshkatarëve dhe familjet e tyre.

2.6.3 Forma e publikimit

Në përfundim të auditimit u përgatit Projekt-Raporti i Auditimit, i cili i dërgohet subjektit të përfshirë në këtë auditim: -Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pas marrjes së observacioneve nga ana e saj grupi i auditimit do të përgatisë Raportin Përfundimtar të Auditimit. Raporti Përfundimtar i Auditimit pas aprovimit nga Kryetari i KLSH-së, do t'i përcillet përsëri subjektit nën auditim dhe njëkohësisht do të publikohet në faqen web të KLSH-së dhe në faqen Facebook të Departamentit të Auditimit të Performancës në KLSH. Gjithashtu në shtypin e përditshëm mund të publikohet një përmbledhje mbi rëndësinë, gjetjet, rekomandimet dhe mesazhin e këtij auditimi. Ky auditim mund të prezantohet edhe në workshop-e të ndryshme që mund të zhvillohen brenda institucionit apo me institucionet homologe, në takimet me grupin e punës së auditimit të çështjeve të mjedisit në komunitetin EUROSAI si dhe në analizën vjetore të institucionit.

3. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËN PYETJEVE

A ka qenë efektiv menaxhimi i sektorit të peshkimit dhe akuakulturës nga MBZHR në zbatim të politikave për këtë aktivitet?

Mesazhi i Auditimit

MBZHR nuk ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore duke dështuar në plotësimin e kuadrit ligjor të peshkimit dhe akuakulturës. Ligji i Akuakulturës i miratuar në vitin 2016 ende nuk ka gjetur zbatim si rezultat i mos miratimit të Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë duke penguar kështu zhvillimin e këtij sektori. Bashkëpunimi jo i mirë midis MBZHR-së dhe institucionit në varësi të saj DSHPA-së si dhe komunikimi i dobët institucional brenda MBZHR-së, janë tregues direkt të mos menaxhimit efektiv të veprimtarisë së peshkimit dhe akuakulturës. Pamjaftueshmëria në mjete logjistike dhe burime njerëzore bën që DSHPA të mos jetë efektive në inspektimin e aktiviteteve lidhur me peshkimin dhe akuakulturën. Mungesa e sistemit të sinjalizimit satelitor për monitorimin e anijeve të peshkimit bën të pamundur identifikimin e lëvizjes së anijeve, kontrollin e peshkimit të paligjshëm dhe regjistrimin e të dhënave në format elektronik.

Portet e peshkimit të vendit tonë menaxhohen në mënyrë jo efektive dhe kanë mungesë të hapësirave ankoruese, kantierëve për riparimin e anijeve të peshkimit si dhe furnizimit me ujë dhe energji elektrike. Ekonomitë e rritjes së rasatit të Koranit në Lin dhe Krapit në Zvezdë nuk furnizohen mjaftueshëm me ujë dhe cilësia e tij nuk është në parametrat e duhura. QGDM Sarandë nuk siguron që e gjithë sasia e prodhuar e midhjeve të kalojë në qendër për certifikim, etiketim apo depurim sipas klasifikimit. Masat e marra nga MBZHR në vitet 2016-2018 për menaxhimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës nuk kanë qenë të mjaftueshme. Mos zbatimi i "Objektivave Specifikë Zhvillimorë" të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit ka bërë që

politikat e ndërmarra nga qeveria për këtë sektor të mos jenë efektive në drejtim të garantimit me cilësi të aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës.

Rekomandimet për problematikat e identifikuara në këtë auditim kanë konsistuar në plotësimin e kuadrit ligjor të peshkimit dhe akuakulturës, riorganizimin e duhur strukturor të MBZHR-së në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit, mbulimin me inspektim të të gjithë zinxhirit të aktivitetit të peshkimit dhe sigurimin e mjeteve logjistike në dispozicion të inspektorëve të peshkimit si dhe përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme të porteve të peshkimit dhe ekonomive të akuakulturës.

3.1 A ka siguruar MBZHR organizimin e duhur strukturor për menaxhimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës dhe a ka ndërmarrë politika strukturore në mbështetje të këtij aktiviteti?

3.1.1 A janë ngritur dhe a bashkëpunojnë si duhet strukturat që kanë përgjegjësi apo janë të përfshira në menaxhimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës?

Në Strategjinë Kombëtare të Peshkimit të miratuar në nëntor të vitit 2016 janë identifikuar disa dobësi që lidhen me burimet njerëzore të MBZHR-së për zbatimin e politikave të peshkimit dhe akuakulturës. Disa prej tyre kanë të bëjnë me mungesën e kapaciteteve për detyrim për zbatim të ligjit, strukturë jo koherente të administratës së peshkimit si dhe mungesë të stafit të nevojshëm dhe të trajnuar.

Për të adresuar dhe zgjidhur këto problematika dhe të tjera që kanë të bëjnë me përmirësimin e performancës në zbatim të politikave për peshkimin dhe akuakulturën në SKP janë vendosur objektiva specifike si:

“- Ristrukturimi dhe forcimi institucional i administratës së peshkimit me personel të mjaftueshëm në të gjitha nivelet duhet të shikohet si prioriteti më i madh i qeverisë për vitin 2017, i shoqëruar me financim të mjaftueshëm për menaxhim, administrim, kontroll dhe kërkim shkencor për peshkimin dhe akuakulturën. - Krijimi i një Drejtorie të Peshkimit dhe Akuakulturës me dy sektorë: një sektor që të fokusohet në çështjet e menaxhimit dhe një sektor që të fokusohet tek çështjet operationale. - Drejtoria e propozuar duhet të ketë një personel minimal prej 10 specialistësh”²². Për të përmbushur Objektivin Specifik të Zhvillimit për forcimin e kapacitetit institucional të MBZHR-së për të administruar me efektivitet sektorin e peshkimit dhe akuakulturës duhet të adoptohen disa masa siç janë krijimi i Drejtorisë së Peshkimit plotësisht funksionale brenda MBZHR-së, ristrukturimi me personelin përkatës i Inspektoratit të Peshkimit dhe miratimi dhe zbatimi i Planit të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore për Drejtorinë e Peshkimit²³.

MBZHR është përgjegjëse për të ngritur/krijuar apo ristrukturuar strukturat ekzistuese si dhe duhet të nxisë bashkëpunimin midis tyre. Përveç strukturave të identifikuara në çështjen 1.4 “*Subjekti nën auditim*” grupi i auditimit ka identifikuar si të rëndësishme për bashkëpunim midis tyre dhe për konsultim edhe struktura të tjera si: Komisioni Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën (KKQPA) dhe Komiteti për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik (KKKSHTTE)²⁴.

²²Strategjia Kombëtare e Peshkimit OSZH 1

²³Strategjia Kombëtare e Peshkimit OSZH 1

²⁴Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin”, i ndryshuar, neni 20,21,22.

Gjithashtu struktura që kanë lidhje dhe mund të kenë përgjegjësi në menaxhimin e aktivitetit të peshkimit janë dhe Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP)²⁵. Këto organizata mbështetur në legjislacionin për peshkimin mund të marrin në menaxhim infrastrukturën e peshkimit bazuar në një marrëveshje të nënshkruar me DSHPA-në. Për të zhvilluar kapacitetet e strukturave të bashkë menaxhimit të peshkimit (OMP-ve) në SKP janë parashikuar aktivitete specifike, si p.sh: hartimi i një memorandumit mirëkuptimi mes MBZHR-së dhe OPM-ve, krijimi i mekanizmave të zgjidhjes së konflikteve apo emërimi dhe trajnimi i monitoruesve, inspektorëve të peshkimit etj.

Për periudhën objekt auditimi grupi i auditimit konstatoi një ndryshim në strukturën e MBZHR-së e identifikuar me përgjegjësi direkt për zbatimin e politikave të peshkimit dhe akuakulturës. Në vitin 2016 ka pasur një Drejtorin Peshkimi (me dy sektorë në përbërje) përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të peshkimit dhe akuakulturës dhe në vitin 2017 kjo drejtori është shpërbërë duke krijuar vetëm dy sektorë në varësi të dy drejtorive të ndryshme.

Ngritja dhe funksionimi i dy komisioneve (KKQPA, KKKSHTE) dhe roli i tyre i rëndësishëm në të gjithë zhvillimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës është parashikuar në Ligjin 64/2012 "Për peshkimin" edhe në SKP. Në strategji parashikohet që këto dy komisione të ngrihen dhe të mblidhen çdo 6 muaj si dhe të trajnohen anëtarët e tyre²⁶. Ky përcaktim ndryshon nga përcaktimi që bën Ligji për Peshkimin ku KKQPA duhet të mblidhet të paktën një herë në vit ndërsa KKKSHTE funksionon sipas rregullores të miratuar nga Ministri²⁷, ku përcaktohet se mblidhet sa herë që Kryetari i sheh të arsyeshme por jo më pak se një herë në vit²⁸. KKKSHTE është krijuar në muajin prill të vitit 2016 dhe po në atë muaj është miratuar edhe rregullorja për funksionimin e tij²⁹.

Grupi i auditimit gjatë kryerjes së auditimit konstatoi se përveç mos ristrukturimit apo mos ngritjes së disa strukturave ka një mungesë të dukshme të bashkëpunimit të strukturave ekzistuese brenda MBZHR-së dhe strukturat në varësi të MBZHR-së. Për shembull: DSHPA është strukturë në varësi të MBZHR-së, pra raporton në MBZHR.

KKQPA ngrihet pranë ministrisë dhe jep mendime dhe sugjerime për çështje të përgjithshme dhe të analizës së zinxhirit të peshkimit, për hyrjen në burime dhe aktivitetin e peshkimit, për politikën strukturale, për organizimin e tregut dhe probleme të akuakulturës.

KKKSHTE ngrihet pranë Ministrisë dhe është një organ i përhershëm konsultativ për çështje që lidhen me studimet e kërkimet me interes shkencor, teknik, shtetëror dhe ekonomik për peshkimin dhe akuakulturën. Sipas ligjit nr. 64/2012 "Për Peshkimin", i ndryshuar, neni 22, anëtarët e komitetit caktohen me urdhër të ministrit dhe kryejnë detyrat e koordinimit të:

- kërkimit dhe vlerësimit të popullatës së peshqve;
- monitorimit të kushteve dhe vlerësimet në lidhje me shfrytëzimin e qëndrueshëm të peshkut dhe organizmave të tjerë detarë;
- përgatitjes së bazës profesionale për planin strategjik kombëtar, planin e menaxhimit dhe atë të zbatimit të peshkimit;
- përcaktimit të termave teknike dhe teknologjike për të gjitha llojet e peshkimit;
- dhënies së asistencës profesionale në aktivitetin e peshkimit.

²⁵ Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin", i ndryshuar

²⁶ Strategjia Kombëtare e Peshkimit Objektivi Specifik #2, 2.2

²⁷ Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin", i ndryshuar, neni 21 dhe neni 22

²⁸ Rregullore nr. 1, datë 22.04.2016 "Mbi funksionimin e KKKSHTE" neni 5, pika 1

²⁹ Urdhër nr. 238, datë 22.04.2016. Rregullore nr. 1, datë 22.4.2016

Gjatë kryerjes së auditimit si dhe në intervistat, takimet dhe pyetësorët e zhvilluar në MBZHR (Sektorët e Politikave dhe Programeve) vihet re që MBZHR përgjigjet “është detyrë e DSHPA-së, nuk kemi informacion”. Ndërkohë rezulton që DSHPA raporton periodikisht në MBZHR nëpërmjet analizave të saj periodike mbi aktivitetin e saj dhe problematikat e lindura. Këto raportime bëhen në nivele të larta të MBZHR –së dhe rezulton që stafi ekzekutiv shpesh herë të mos marrë informacionin e duhur.

Për periudhën objekt auditimi OMP-të kanë pasur në menaxhim 2 nga 4 portet e peshkimit që ka vendi ynë. Problematikat që janë konstatuar në zbatimin e marrëveshjes së menaxhimit të porteve nga këto OMP trajtohen në pyetjen 1.4.1 të auditimit.

Për sa i takon sektorit të akuakulturës në SKP janë përcaktuar objektiva specifike për zhvillimin e këtij sektori. Përkatësisht Objektivi Specifik i Zhvillimit #11 parashikon hartimin e një plani strategjik kombëtar shumë-vjeçar për akuakulturën në Shqipëri deri në janar të vitit 2018 dhe OSZH #12 parashikon ngritjen e një sistemi efektiv dhe transparent të lejeve dhe licencave për akuakulturën nëpërmjet krijimit të një njësie të licencimit deri në fund të vitit 2017.

Gjetje:

1. MBZHR nuk ka ndryshuar strukturën organizative të saj në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit.
2. MBZHR nuk ka një Plan të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore për Drejtorinë/Sektorët e Peshkimit siç është parashikuar në SKP.
3. Numri i punonjësve që mbulojnë sektorët përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën në organikën e brendshme të MBZHR-së është i pamjaftueshëm.
4. Ministri i MBZHR për vitet 2016 dhe 2017 nuk ka ngritur Komisionin Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën.
5. Kryetari i Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik nuk ka mbledhur komisionin për vitin 2017 dhe 2018.
6. DSHPA ka raportuar periodikisht pranë Ministrisë të MBZHR-së analizat vjetore institucionale. Për periudhën objekt auditimi këto analiza nuk i kanë kaluar asnjëherë Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Sektorit të Programeve të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës.
7. Sektori i menaxhimit të Porteve të Peshkimit (DSHPA/MBZHR) nuk ka hartuar një Memorandum Mirëkuptimi me OMP-të në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit dhe Planeve të Menaxhimit të Peshkimit.
8. Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në MBZHR nuk ka hartuar ende një plan strategjik kombëtar për akuakulturën.
9. Përgjegjësi i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës [REDAKTUAR] me largimin e tij nga detyra në muajin mars 2019 nuk ka bërë dorëzimin e detyrës dhe dokumentacionit në kundërshtim me detyrimet që përcakton kuadri ligjor për nëpunësin civil³⁰.

³⁰ VKM nr. 124, datë 17.02.2016 Për Pezullimin dhe Lirimin nga Shërbimi Civil

Konkluzione:

1. Krijimi i Drejtorisë së Peshkimit plotësisht funksionale brenda MBZHR-së si një prej strukturave kryesore të peshkimit është një nga objektivat kryesorë të SKP-së i cili nuk është vënë në zbatim nga MBZHR. MBZHR jo vetëm që nuk e ka marrë në konsideratë këtë objektiv të SKP-së, por në vitin 2017 Drejtorinë ekzistuese të Peshkimit e shkriu duke krijuar dy sektorë në varësi të dy drejtorive të ndryshme si rezultat duke çenuar efektivitetin e menaxhimit të aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës.
2. Në Objektivin Specifik të Zhvillimit #1 të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit janë cituar indikatorët që bëjnë të mundur matjen dhe realizueshmërinë e këtij objekti. Mos miratimi i Planit të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore ka sjellë mos përmbushjen e indikatorit nr. 3 të OSZH #1 dhe mos zhvillim efektiv të Burimeve Njerëzore.
3. Numri aktual i punonjësve përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën në organikën e brendshme të MBZHR-së nuk është në përputhje me nevojat e identifikuar në SKP. Aktualisht në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës dhe në Sektorin e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës gjenden 6 punonjës nga minimumi 10 që rekomandon SKP. Kjo mungesë punonjësish cenon efektivitetin e procesit të menaxhimit të aktiviteteve të peshkimit dhe akuakulturës.
4. Mos ngritja e KKQPA në vitet 2016 dhe 2017 ka sjellë mungesë të dhënies së mendimeve dhe sugjerimeve nga ana e këtij komisioni lidhur me përmirësimin efektiv të çështje të ndryshme të peshkimit dhe akuakulturës.
5. Komiteti për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik edhe pse është ngritur në vitin 2016, për vitet 2017 dhe 2018 ai nuk është mbledhur për të trajtuar çështje që lidhen me studimet me interes shkencor, teknik, shtetëror dhe ekonomik për peshkimin dhe akuakulturën dhe për të dhënë mendime mbi zhvillimin efektiv të sektorëve . Në Rregulloren nr. 1 datë 21.04.2016 “Mbi funksionimin e komitetit për koordinimin e kërkimit shkencor, teknik dhe ekonomik për peshkimin dhe akuakulturën” neni 5 pika 1 citohet se “KKKSHTË mblidhet sa herë Kryetari e sheh të arsyeshme për sidoqoftë jo më pak se një herë në vit”.
6. Mos dërgimi i analizave vjetore të DSHPA-së në strukturat ekzekutive përkatëse të MBZHR-së (Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Sektorit të Programeve të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës) sjell mos njohjen e problematikave të ndryshme të peshkimit dhe akuakulturës nga këta sektorë. Komunikimi i brendshëm në MBZHR ka mangësi të theksuara dhe nuk është efektiv.
7. Mungesa e hartimit të një Memorandumi Mirëkuptimi midis MBZHR-së dhe OMP-ve nuk ka sjellë përmirësim sa i përket bashkë menaxhimit në peshkimin detar, liqenor dhe lagunor.
8. Mungesa e hartimit të një plani strategjik për akuakulturën nuk ka sjellë zhvillim efektiv të sektorit të akuakulturës përmes një përafrimi të planifikimit

strategjik referuar Objektivit Specifik të Zhvillimit #11 të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit.

9. Grupi i Auditimit gjatë fazës së ekzekutimit të auditimit ka hasur vështirësi në vënien në dispozicion të dokumentacionit nga specialistët e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës të cilët nuk dispononin dokumentacionin që për periudhën objekt auditimi 2016-2018 është administruar nga ish Përgjegjësi i Sektorit [REDACTED].

Rekomandime:

1. MBZHR të marrë masa për të krijuar Drejtorinë e Peshkimit brenda strukturës së saj në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit si dhe të shtojë numrin e punonjësve në këtë Drejtori minimumi 10 punonjës në total.

Prill 2020

2. MBZHR të hartojë dhe miratojë Planin e Zhvillimit të Burimeve Njerëzore për punonjësit e Drejtorisë/Sektorëve të Peshkimit me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre dhe përmirësimin e performancës në përmbushjen e detyrave funksionale.

Mars 2020

3. Ministri i MBZHR-së të mbledhë Komisionin Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën çdo vit.

Çdo vit

4. Kryetari i komitetit të marrë masa për të mbledhur Komitetin për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik çdo vit.

Çdo vit

5. Niveli drejtues i MBZHR-së të marrë masa që raportimet periodike (analizat vjetore institucionale) të DSHPA-së dhe çdo informacion tjetër lidhur me zhvillimet që ndodhin në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës t'i përcillen nivelit ekzekutiv (Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Sektorit të Programeve të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës).

Vazhdimisht

6. Sektori i menaxhimit të Porteve të Peshkimit (DSHPA/MBZHR) të hartojë dhe të firmosë një Memorandum Mirëkuptimi me OMP-të në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit.

Qershor 2020

7. Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në MBZHR të hartojë Planin Strategjik Kombëtar për Akuakulturën.

Qershor 2020

8. Njësia Përgjegjëse në MBZHR (Sektori Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit) lidhur me mos dorëzimin e detyrës dhe dokumentacionit nga [REDACTED] të marrë masat e nevojshme në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar dhe VKM nr. 124, datë 17.02.2016 "Për Pezullimin dhe Lirimin nga Shërbimi Civil.

Menjëherë

3.1.2 Cilat kanë qenë fushat e ndërhyrjeve strukturore që MBZHR ka dhënë mbështetje në drejtim të peshkimit dhe akuakulturës?

MBZHR ofron mbështetje për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës nëpërmjet Programit Mbështetje për Peshkimin. Gjithashtu këto sektorë mbështeten me Investimeve të Huaja, subvencione nga AZHBR apo nisma të tjera të qeverisë. Në zbatim të legjislacionit për peshkimin dhe akuakulturën MBZHR duhet të ofrojë mbështetje strukturore (financiare) për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës. Fushat e ndërhyrjeve strukturore për peshkimin mund të jenë:

- Mbështetja për pronarët e anijeve të peshkimit;
- Mbështetja për ndalimin e përkohshëm të aktivitetit të peshkimit;
- Mbështetja për investime në bordin e anijeve të peshkimit për sigurinë në bord, furnizimin me karburant, përmirësimin e kushteve të punës, higjienës e efikasitetit energjetike dhe selektiviteti i mjeteve të peshkimit, me kusht që të mos sjellë një rritje të sforcove të peshkimit.
- Mbështetje për peshkimin e vogël bregdetar artizanal, etj³¹.

Fushat e ndërhyrjeve strukturore në drejtim të akuakulturës mund të jenë³²:

- investime në prodhim;
- masat për mbrojtjen dhe parandalimin e dëmtimit të mjedisit;
- masat për shëndetin publik;
- masat veterinarë etj.

Për periudhën 2016-2018 mbështetja për zhvillimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës është si më poshtë:

1. Investime nga Programi Mbështetje për Peshkimin për vitet 2016-2018 (*Shiko aneksin 1*).
 - Bashkëfinancim për Projektin e Portit të ri të peshkimit në Durrës;
 - Hartimi i projektit të zbatimit për "Ndërtimi i tregut të shitjes me shumicë të peshkut në Shëngjin";
 - Hartimi i projektit të zbatimit për "Thëllimi i kanalit Bistricë";
 - "Pajisje Laboratorike" për Qendrën e Grumbullimit dhe Depurimit të Midhjes dhe Ekonomisë e rritjes së rrasave.

Ajo që vërehet nga planifikimi i investimeve të brendshme është se disa investime të parashikuara nuk janë realizuar. Këto investime janë si më poshtë:

- Investimi i parashikuar për ngritjen e sistemit të sinjalizimit VMS, nuk janë përdorur pasi me VKM të gjitha sistemet e IT kanë kaluar tek AKSHI.
- Investimi për blerjen e bankinave të lëvizshme për portet e peshkimit janë transferuar në buxhetin e DSHPA-së në fund të nëntorit 2016 dhe menjëherë nga DSHPA është hapur procedura e prokurimit publik, por në datën e hapjes së ofertave nuk ka pasur asnjë ofertë dhe Njësia e Prokurimit ka anuluar procedurën pasi afati kohor nuk mjaftonte për rihapje të procedurave³³.
- Investime për ndërtimin e tregut të peshkut Shëngjin i cili është realizuar në masën 10%. Fondi i parashikuar nuk u realizuar i plotë, pasi kontrata për

³¹Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin", i ndryshuar, neni 18

³²Ligji nr. 103/2016 "Për Akuakulturën", neni 40

³³Shkresë Nr. 19599/1, datë 21.11.2018 "Transferim Fondi".

ndërtimin e tregut është lidhur në muajin shtator. Që nga lidhja e kontratës e deri në fund, afati ka qenë përtej vitit 2018 dhe prandaj edhe për vitin 2019 është planifikuar sipas tavanëve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbulimi pjesërisht i këtij detyrimi.

2. Investimet e Huaja për periudhën 2016-2018 (*Shiko aneksin 1*):

- Dokumenti Sektorial për Peshkimin (Strategjia Kombëtare e Peshkimit);
- Projekti për portin e ri të peshkimit në Durrës.

3. Mbështetje të tjera për aktivitetin e peshkimit:

- Aktiviteti i peshkimit detar subvencionohet për TVSH e naftës (merr naftë pa akcizë), kjo në bazë të sasisë së peshkut të zënë që deklarohet tek libri i zënieve i anijeve të peshkimit³⁴.
- Heqja e taksës së qarkullimit për mjetet dhe veglat e peshkimit (anije, rrjeta, litar e spiranca çeliku e gize, grepa peshkimi, kallama peshkimi etj)³⁵.
- Mbështetje ndaj anijeve të peshkimit me flamur shqiptar, në vlerën 20 (njëzet) lekë/kg për açuge dhe/ose sardele të peshkuara. Pagesa kryhet kundrejt sasive të tregtuara në stabilimentet shqiptare vetëm për qëllime përpunimi të këtyre produkteve, të vërtetuara me fatura tatimore dhe certifikata të zënieve³⁶.

Si përfundim mund të themi se për vitet 2016-2017 aktiviteti i peshkimit dhe akukulturës është mbështetur minimalisht me investime nga MBZHR dhe madje një pjesë e investimeve të planifikuara nuk janë realizuar.

3.2 A është i plotë, gjithëpërfshirës, i zbatueshëm, bashkëkohor dhe i përditësuar kuadri ligjor që mbulon aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës?

3.2.1 A janë miratuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e peshkimit dhe të akuakulturës?

Për të rregulluar aktivitetin e peshkimit dhe të akuakulturës në vendin tonë janë të miratuara politikat dhe kuadri ligjor përkatës duke filluar nga Strategjia Kombëtare e Peshkimit, Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin”, Ligji nr. 103/2016 “Për Akuakulturën” si dhe akte të tjera nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tyre. Strategjia Kombëtare e Peshkimit ka si qëllim prezantimin e një vizioni të përgjithshëm strategjik për zhvillimin afatmesëm të sektorëve të peshkimit dhe akuakulturës. Ajo përcakton objektivat dhe prioritetet e Shqipërisë, të cilat janë në përputhje me ato të Politikës së Përbashkët të Peshkimit të BE. SKP udhëhiqet nga legjislacioni përkatës i politikave të BE për peshkimin, në mënyrë specifike nga Rregullorja (BE) 1380/2013 (Politika e

³⁴VKM Nr. 29, datë 14.1.2015 “Për për caktimin e procedurave, të sasive, të kushteve dhe kritereve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit”. Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 18, datë 15.6.2015 “Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gazoil) me përjashtim nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akcisa”

³⁵VKM Nr. 652, datë 10.11.2017”Për disa ndryshime e shtesa në VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

³⁶<http://azhbr.gov.al/skema-kombetare/peshkim/>

Përbashkët e Peshkimit)³⁷. SKP është e ngritur mbi pesë Objektiva të Nivelit të Lartë (ONL), të cilat janë si vijon:

- Përafrimi i administrimit dhe legjislacionit të peshkimit me praktikën dhe standardet aktuale të BE për të forcuar kontributin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës në ekonomi dhe për të përgatitur pranimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.
- Garantimi që aktivitetet e peshkimit janë të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore dhe menaxhohen në mënyrë të tillë që do të sigurojë marrjen e përfitimeve ekonomike, sociale dhe të punësimit, si dhe të kontribuojë në disponueshmërinë e furnizimit me ushqim.
- Burime të qëndrueshme peshkore në lagunat bregdetare dhe ujërat e brendshme, të cilat (burimet) shfrytëzohen në një mënyrë të përgjegjshme dhe të kontrolluar nëpërmjet një partneriteti për bashkë menaxhimin e zgjuar dhe të bazuar tek njohuritë.
- Ngritja e një industrie konkurruese dhe të qëndrueshme të akuakulturës, e cila kontribuon në sigurinë ushqimore kombëtare dhe rritjen blu.
- Organizimi i tregut, cilësisë së peshkut, përpunimit dhe tregtimit, me qëllim rritjen e vlerës së shtuar të nën-sektorëve të peshkimit dhe akuakulturës.

Këto ONL në vijim janë zbërthyer në gjashtëmbëdhjetë Objektiva Specifikë të Zhvillimit dhe më tej në masa të propozuara që duhen adoptuar për vënien në jetë të SKP-së.

Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin", rregullon aktivitetin e peshkimit në tërësi, menaxhimin e tij si dhe siguron mbrojtjen e gjallesave detare dhe të ujërave të brendshme, nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm nëaktivitetin në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë. Qëllimi kryesor i këtij ligji është të përcaktojë rregullat për menaxhimin dhe bashkëmenaxhimin e sektorit të peshkimit si dhe të sigurojë një shfrytëzim racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të brendshme. Nëpërmjet këtij ligji përcaktohen masat dhe rregullat e nevojshme për kontrollin, inspektimin dhe zbatimin e politikave të peshkimit dhe ngritja e një sistemi kontrolli për peshkimin dhe vendosjen e procedurave të inspektimit të standardizuara dhe të koordinuara. Ky ligj gjithashtu përcakton edhe nxitjen dhe përkrahjen e kërkimit shkencor e teknologjik dhe grumbullimit të të dhënave në peshkim. Ligji mbulon të gjitha veprimtaritë e peshkimit që zhvillohen në territorin e vendit tonë siç është veprimtaria e mjeteve lundruese shqiptare dhe ato të huaja që kërkojnë të ushtrojnë apo ushtrojnë aktivitet peshkimi në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë. Për mirëfunktionimin e aktivitetit të peshkimit dhe për të përafruar legjislacionin më atë të Komunitetit Europian Ligji i Peshkimit ka pësuar dy ndryshime ndër vite³⁸. Mbështetur në setin e rregullave për peshkimin që BE ka hartuar në Common Fishery Policies, edhe Shqipëria ka pasur ecurinë e saj në përafrimin e pjesshëm e deri diku të plotë të akteve ligjore për peshkimin me atë të Komunitetit Europian.

³⁷Rregullorja (BE) Nr. 1380/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 11 dhjetor 2013 për Politikën e Përbashkët të Peshkimit (Common Fisheries Policy)

³⁸Ligji nr. 80/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në 64/2012 "

Ligji nr. 4/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në 64/2012 "Për Peshkimin", të ndryshuar

Ligji nr. 103/2016 "Për Akuakulturën" rregullon zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës së tërësi duke përcaktuar bazën e nevojshme ligjore për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të prodhimit dhe kultivimit të organizmave ujorë në fushën e akuakulturës në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai ka për qëllim të kontribuojë në nxitjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së akuakulturës, nëpërmjet rritjes së konkurrencës dhe përfitimeve në këtë sektor, duke respektuar zhvillimin e ekuilibruar e të qëndrueshëm mjedisor në vend. Që me miratimin e tij në vitin 2016 ky ligj ka pësuar vetëm një përditësim me qëllim përafrimin e pjesës së tij me legjislacionin e Bashkimit Europian³⁹.

Miratimi dhe hyrja në fuqi e dy ligjeve kryesore të sipërcituara të cilat rregullojnë aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës në Republikën e Shqipërisë, si dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare të Peshkimit i detyrojnë strukturat përgjegjëse në MBZHR⁴⁰, të hartojnë dhe të marrin masa për miratimin e akteve ligjore, nënligjore dhe rregullatore që duhet të shoqërojnë dhe ndihmojnë në zbatimin e këtyre ligjeve. Kështu, nga shqyrtimi që i është bërë dy ligjeve kryesore dhe Strategjisë Kombëtare të Peshkimit nga grupi i auditimit, kanë rezultuar rreth pesëdhjetë akte nënligjore të cilat duhet të plotësojnë kuadrin ligjor për peshkimin⁴¹ dhe akuakulturën⁴² dhe të ndihmojnë në zbatimin sa më korrekt të tij. Një pjesë e mirë e këtyre akteve janë hartuar dhe miratuar, disa nga të cilat gjatë vitit 2019. Si pjesë e rëndësishme e akteve nënligjore dhe rregullatore që bëjnë të mundur zbatimin e ligjit të peshkimit është dhe Plani i Zbatimit të Peshkimit i cili rrjedh si detyrim nga neni 26 i Ligjit të Peshkimit i cili përmban objektivat që synohen të arrihen gjatë afatit të caktuar apo menaxhimin mbi bazë sistemi.

Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin" parashikon që të miratohet me VKM mënyra dhe koha kur duhet të bëhet funksional sistemi për regjistrimin elektronik dhe transmetimin e të dhënave të librit të anijes së peshkimit, procedurat e shitjes së parë të produkteve të peshkimit miratohen po ashtu me VKM. Të tjera detyrime që lindin nga ligji i peshkimit është dhe miratimi nga Ministri i Manualit mbi detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorëve për peshkimin, apo dhe aplikimi i sistemit të pikëve për shkeljet e rënda. Në nenin 130 të Ligjit nr. 64/2012 "Për Peshkimin" citohet se lejet e peshkimit, autorizimi ose e drejta e peshkimit, për qëllime sanksionimi për shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit, të kenë vlerën maksimale 90 pikë dhe për penalitete të ndryshme t'i ulen pikët në bazë të shkeljes, deri kur arrin në kuotën 18 pikë, kur leja e tij e peshkimit, autorizimi ose e drejta e peshkimit pezullohet automatikisht për dy muaj. Në zbatim të këtij neni është hartuar dhe miratuar VKM nr. 407, datë 08.05.2013 "Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim". Në këtë VKM janë gjithsej 13 shtojca, nga të cilat për periudhën objekt auditimi ka munguar Shtojca nr. 12, për aplikimin e sistemit të pikëzimit. Rrjedhimisht ky sistem pikëzimi nuk është

³⁹ Ligji nr.22/2019, datë 3.4.2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.103/2016 "Për akuakulturën".

⁴⁰Spektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Spektori i Programeve të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në MBZHR.

⁴¹ Ligji nr. 64, datë 31.05.2012, "Për peshkimin".

⁴² Ligji nr. 103/2016, "Për Akuakulturën".

aplikuar. Kjo çështje është rregulluar vetëm në vitin 2019 me miratimin e VKM-së nr. 255, datë 24.4.2019 “Për një ndryshim të VKM nr. 407 datë 8.5.2013” Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”.

Ligji nr. 103/2016 “Për Akuakulturën” kërkon miratimin e disa VKM-ve, Urdhrave apo Udhëzimeve për ta bërë atë plotësisht të aplikueshëm dhe për të përmbushur objektivin dhe qëllimin e tij. Aktet nënligjore që grupi i auditimit konstatoi që duhet të miratohen janë:

- VKM mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA)⁴³.
- Planet e monitorimit mbi ecurinë e zhvillimit e aktiviteteve të akuakulturës⁴⁴;
- VKM mbi formën e dokumenteve, procedurës dhe përmbajtjes së kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës⁴⁵;
- Udhëzim mbi kërkesat për krijimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës⁴⁶;
- Udhëzim mbi kultivimin e organizmave ujorë të egër⁴⁷;
- Udhëzime mbi nivelin e nevojshëm të kualifikimit për kategoritë e zhvillimit të aktivitetit⁴⁸.

Në Qershor 2018, vendi ynë ka raportuar lidhur me punën e bërë për implementimin e Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara (Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm). Në këtë raport ku tregohet puna që është bërë për të integruar apo përfshirë OZHQ në prioritetet, strategjitë dhe qëllimet kombëtare, vihet re se Qëllimi 14 “Life below water” është më pak i integruari me prioritetet, politikat, qëllimet dhe objektivat e qeverisë (<25%- fq.11,13)⁴⁹. Synimet kryesore që ka ky objektivi të lidhura me peshkimin dhe akuakulturën janë:

- Deri në vitin 2020, t’i jepet fund mbi peshkimit, praktikave të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar të peshkimit dhe të fillojë implementimi i planeve të menaxhimit të bazuar në shkencë, në mënyrë që të rikuperohen rezervat e peshkut në kohën më të shkurtër të mundshme, të paktën në nivele që mund të prodhojnë rendiment maksimal të qëndrueshëm siç përcaktohet nga karakteristikat e tyre biologjike.
- Deri në vitin 2020, të jenë ndaluar forma të caktuara të subvencioneve të peshkimit, të cilat kontribuojnë në tejkalim të kapacitetit dhe mbi peshkim, të eliminohen subvencione që kontribuojnë në peshkim të paligjshëm, të pa raportuar dhe të parregulluar, duke patur parasysh që duhen marrë masa të veçanta dhe të ndryshme por efektive për vendet në zhvillim dhe për vendet më pak të zhvilluara, të cilat duhet të jenë pjesë integrale e negociatave të subvencioneve të peshkimit nga Organizata Botërore e Tregtisë.

⁴³ Ligji nr. 103/2016, “Për Akuakulturën, neni 5 pika 2.

⁴⁴ Ligji nr. 103/2016, “Për Akuakulturën, neni 7

⁴⁵ Ligji nr. 103/2016, “Për Akuakulturën, neni 17

⁴⁶ Ligji nr. 103/2016, “Për Akuakulturën, neni 19, pika 2.

⁴⁷ Ligji nr. 103/2016, “Për Akuakulturën, neni 28.

⁴⁸ Ligji nr. 103/2016, “Për Akuakulturën, neni 33, pika 3.

⁴⁹Voluntary National Review on Sustainable Development Goals, Albania, 2018

- T'u sigurohet aksesimi në burimet detare dhe në treg peshkatarëve të vegjël artizanalë etj.

Në lidhje me këto qëllime sa i takon pjesës për dhënien fund të praktikave të palejuara të peshkimit, progresi është thujse i padukshëm, gjë që do pasqyrohet në mënyrë të plotë në pikat në vijim të projekt raportit të auditimit. Ajo që është arritur në lidhje me këto synime, të cilët janë të zberthyer në vijim në indikatorë, është vënia në zbatim e përqindjes së rezervave të peshkut në nivele biologjikisht të qëndrueshme, si dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga GFCM me qëllim vënien në zbatim të tyre.

Gjetje:

1. MBZHR nuk ka një Plan Veprimi për Strategjinë Kombëtare të Peshkimit.
2. Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në MBZHR nuk ka monitoruar progresin e bërë në përmbushje të objektivave specifike të zhvillimit të SKP-së.
3. MBZHR nuk ka përgatitur dhe nuk ka miratuar Planin e Zbatimit të Peshkimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 64/2012 "Për Peshkimin", i ndryshuar, neni 26, pika 3.
4. Regjistrimi elektronik dhe transmetimi i të dhënave të librit të anijes së peshkimit nuk është miratuar me VKM sipas kërkesave të Ligjit nr. 64/2012 "Për Peshkimin", i ndryshuar, neni 77, pika 3.
5. Nuk është miratuar VKM mbi procedurat për shitjen e parë të produkteve të peshkimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 64/2012 "Për Peshkimin", i ndryshuar, neni 112, pika 3.
6. Nuk janë miratuar me VKM Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë sipas kërkesave të Ligjit nr. 103/2016 "Për Akuakulturën", neni 5, pika 2.
7. Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Sektori i Programeve të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në MBZHR nuk kanë miratuar planet e monitorimit të aktiviteteve të akuakulturës sipas kërkesave të Ligjit nr. 103/2016 "Për Akuakulturën", neni 7, pika 2.
8. Forma e dokumenteve, procedura dhe përmbajtja e kontratës që lidhet midis palëve nuk është miratuar me VKM sipas kërkesave të Ligjit nr. 103/2016 "Për Akuakulturën", neni 17.
9. MBZHR nuk ka miratuar Udhëzimet përkatëse në zbatim të Ligjit nr. 103/2016 "Për Akuakulturën", neni 19, pika 2, neni 28 dhe neni 33 pika 3.

Konkluzione:

1. Plani i Veprimit të SKP-së bën të mundur zberthimin në hapa konkrete të aktiviteteve të parashikuara në këtë Strategji. Mungesa e Planit të Veprimit ka sjellë që puna e MBZHR-së për aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës të mos jetë efciente, të mos orientohet dhe të mos jetë në linjë me objektivat specifike të zhvillimit dhe përmbushjen e tyre.
2. Mungesa e monitorimit dhe vlerësimit të fazës së zbatimit të objektivave të vendosura bën që MBZHR të mos ketë informacion mbi progresin e bërë në

zbatimin e SKP dhe nëse këto objektiva do të përmbushen në mënyrë efektive brenda afatit të Strategjisë (2016-2021).

3. MBZHR në mungesë të “Planit të Zbatimit të Peshkimit” ka mangësi në menaxhimin eficient të aktivitetit të peshkimit sa i përket monitorimit të gjendjes së popullatave të llojeve të peshkut, analizimit të popullatës së peshkut, masat teknike që duhen zbatuar, metodave të peshkimit, gjendjes aktuale të shfrytëzimit etj.
4. Mos miratimi me VKM i procedurës së regjistrimit elektronik cenon eficientëtranzmetimit të të dhënave të ndryshme të librit të anijes së peshkimit.
5. MBZHR nuk ka siguruar që produktet e peshkimit të tregtohen apo regjistrohen në qendrat përkatëse të ankandit duke qenë se mungon VKM-ja mbi procedurat për shitjen e parë të produkteve të peshkimit. Mos miratimi i një VKM-je sjell që procesi i regjistrimit dhe tregtimit të produkteve të peshkimit të mos jetë eficient.
6. Mos miratimi i ZPA-vë ka sjellë mos zhvillimin e sektorit të akuakulturës pasi në zbatim të Ligjit 103/2016 “Për Akuakulturën”, neni 50, pika 3 përcakton se lidhja e kontratave për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës pezullohet deri në momentin e miratimit të ZPA-ve.
7. “Planet e monitorimit të aktiviteteve të akuakulturës”, “Forma e dokumenteve, procedura dhe përmbajtja e kontratës” dhe Udhëzimet përkatëse në zbatim të Ligjit nr. 103/2016 “Për Akuakulturën”, neni 19, pika 2, neni 28 dhe neni 33 pika, nuk janë miratuar si rezultat i mos përcaktimit të ZPA-së. Ligji nr. 103/2016 “Për Akuakulturën” përcakton se këto akte nënligjore duhen realizuar pas përcaktimit të ZPA-së.

Rekomandime:

1. Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në MBZHR të kryejë një raport vlerësimi mbi nivelin e përmbushjes së objektivave specifike zhvillimore të SKP-së.

Qershor 2020

2. Pas hartimit të raportit të vlerësimit mbi nivelin e përmbushjes së objektivave specifike zhvillimore të SKP-së, Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës të hartojë Planin e Veprimit për periudhën e mbetur të Strategjisë.

Dhjetor 2020

3. MBZHR të hartojë dhe miratojë Planin e Zbatimit të Peshkimit.

Shtator 2020

4. MBZHR të hartojë dhe dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave draftin mbi regjistrimin elektronik dhe transmetimin e të dhënave të librit të anijes së peshkimit.

Mars 2020

5. MBZHR të hartojë dhe dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave draftin mbi procedurat për shitjen e parë të produkteve të peshkimit.

Mars 2020

6. MBZHR të iniciojë menjëherë punën për konsultimin me Ministrinë përgjegjëse⁵⁰ me qëllim përgatitjen dhe miratimin e ZPA-ve. Në përfundim të procesit të konsultimit, **të hartohet Draft-VKM dhe t'i dërgohet për miratim Këshillit të Ministrave.**

Dhjetor 2020

7. Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Sektori i Programeve të Zhvillimit në fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në MBZHR të marrin masa për të miratuar planet e monitorimit të aktiviteteve të akuakulturës.

Tre muaj pas miratimit të ZPA-ve

8. MBZHR të hartojë dhe dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave draftin e Formës së dokumenteve, procedurës dhe përmbajtjes së kontratës që lidhet midis palëve.

Tre muaj pas miratimit të ZPA-ve

9. MBZHR të miratojë Udhëzimet përkatëse në zbatim të Ligjit nr. 103/2016 “Për Akuakulturën”, neni 19, pika 2, neni 28 dhe neni 33 pika 3.

Një muaj pas miratimit të ZPA-ve

3.3 A mbulohet në mënyrë efektive i gjithë vendi dhe i gjithë zinxhiri i aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës me monitorim, vëzhgim, kontroll, inspektim dhe mbikqyrje?

3.3.1 A ka MBZHR burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme për të përmbushur detyrat që i ngarkon legjislacioni përkatës?

Autoritetet e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës janë Inspektorati i Peshkimit (IP) dhe QNOD-ja⁵¹. Këto dy struktura janë pjesë e DSHPA-së si dy sektorë të ndryshëm që ndajnë përgjegjësitë dhe detyrat si dhe duhet të bashkëpunojnë ngushtë për të kontrolluar dhe monitoruar aktivitetet e peshkimit të realizuara nga personat fizikë dhe ata juridikë. Inspektorati i Peshkimit dhe QNOD-ja sigurojnë zhvillimin e kontrollit, inspektimin dhe zbatimin e dispozitave të tjera të legjislacionit të peshkimit dhe akuakulturës. Si pjesë e strukturave që duhet të përfshihen për të funksionuar sistemi i MKV janë edhe *vëzhguesit* dhe *monitoruesit*.

Inspektorati i Peshkimit është autoriteti përgjegjës që kryen inspektimin mbi baza jo diskriminuese, në det, në porte, gjatë transportit, gjatë procesit të përpunimit dhe në tregun e shitjes së peshkut dhe të nënprodukteve të tij. Inspektorët e peshkimit kanë për detyrë të kontrollojnë⁵²:

- rregullsinë e zënieve që ndodhen në bordin e mjetit lundrues të peshkimit, të magazinuara, të transportuara, në përpunim apo të tregtuara, si dhe vërtetësinë dhe saktësinë e dokumenteve apo transmetimeve elektronike që lidhen me to;
- rregullsinë e veglave të peshkimit të përdorura për llojet, objekt kontrolli, dhe për zëniet e tyre që janë në bordin e anijes së peshkimit;

⁵⁰ Ligji nr. 103/2016 “Për Akuakulturën”, neni 5 pika 2.

⁵¹ Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin” i ndryshuar, neni 68

⁵² Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin” i ndryshuar, neni 122, pika 1.

- nëse është e përshtatshme, planin e ngarkesës dhe ngarkesat e veçanta të llojeve;
- shënjimin e veglave të peshkimit;
- informacionin përkatës për motorin.

Inspektorati i Peshkimit ka varësi të dyfishtë funksionale. Ai është në varësi të MBZHR-së/DSHPA-së dhe në varësi të Inspektoratit Qendror (IQ).

Si pjesë e MBZHR-së/DSHPA-së ai bën planin e tij vjetor të punës i cili miratohet nga Ministri. Ky plan vjetor hartohet nga inspektorët duke u bazuar në problematikat që ka sektori i peshkimit dhe akuakulturës, në urdhrat e Ministrit për të ndaluar peshkimin në periudhat e shumimit dhe në përvojën e inspektorëve. Në qëllim të këtij plani është marrja e masave që të zbatohet legjislacioni për peshkimin dhe akuakulturën. Si një nga inspektoratet që janë pjesë e IQ ai ka detyrime që i linden nga Ligji nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Përkatësisht në zbatim të ligjit të inspektimit IP:

- Kryen inspektime bazuar në sistemin online dhe të gjithë inspektorët janë të pajisur me pajisjet e nevojshme duke filluar që nga muaji korrik i vitit 2017;
- Të dhënat e inspektimeve hidhen në bazën qendrore të të dhënave dhe është IQ ai që menaxhon këtë bazë të dhënash;
- Përgjegjësi i Sektorit të Inspektimit në DSHPA ka akses të plotë në këtë bazë të dhënash që lidhen me peshkimin për t’i përpunuar dhe për të nxjerrë informacione dhe statistika të ndryshme lidhur me to (detyrë që i është deleguar nga Drejtori i DSHPA-së);
- Format i proces-verbaleve që zbaton IP është ai që ka miratuar IQ me Urdhrin Nr. 25, Datë 10.8.2018 Për miratimin e Rregullores “Për Përcaktimin e Procedurës së Inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”;
- Harton planin vjetor të inspektimeve sipas metodologjisë së IQ e cila bazohet vetëm në numrin e inspektorëve;
- Në gjithë kryerjen e inspektimeve bazohet në metodologjinë e miratuar nga IQ.

Vlen për tu theksuar se në planifikimin dhe ekzekutimin e inspektimeve dhe kontrolleve si dhe në marrjen e detyrave IP nuk varet nga IQ por nga MBZHR/DSHPA. Lidhur me raportimin ai bëhet pranë të dy institucioneve.

DSHPA / Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit bën një plan vjetor pune që miratohet nga Ministri. Ky plan vjetor hartohet nga vetë inspektorët mbështetur në urdhrat e Ministrit për të ndaluar peshkimin në periudhat e shumimit, në problematikat që ka sektori i peshkimit dhe akuakulturës, si dhe në përvojën e inspektorëve. MBZHR/DSHPA/IP duhet të përgatisë Programin Kombëtar të Kontrollit i cili duhet të miratohet me VKM dhe duhet të publikohet në faqen zyrtare të ministrisë⁵³.

Për kryerjen e inspektimeve Inspektorati i Peshkimit bazohet në legjislacionin për peshkimin dhe akuakulturën, ligjin për Inspektimin si dhe aktet nënligjore në fuqi⁵⁴.

⁵³Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin” i ndryshuar, neni 100. VKM 407, datë 08.05.2013, pika 104,105.

⁵⁴Ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar;

Ligji nr. 103/2016 “Për akuakulturën”;

Ligji nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” ;

Rregullore nr. 1, datë 07.03.2014 “Për zbatimin e Ligjit nr. 64, datë 31.05.2012 “Për peshkimin”;

Nga ky kuadër ligjor IP i lindin detyrime për të kryer inspektime dhe kontrole në të gjithë zinxhirin e peshkimit dhe akuakulturës. Për të mbuluar me inspektime këtë sektor kontrollet janë të grupuara në këto kategori:

- Kontrole në port ose në bregdet në momentin e ardhjes së anijes;
- Kontrole në det/liqen;
- Kontrole në ujërat e brendshme;
- Kontrole në pikat e tregtimit/magazinimit/restorantet.

Kontrolli kryhet në ujëra apo në tokë, përfshirë portet, pikat e zbarkimit, mjetet e transportit, qendrat e grumbullimit të peshkut, merkatot, pikat e shitjes dhe restorantet.

Për të kryer me sukses planin e tij vjetor të punës si dhe për të përmbushur të gjitha detyrimet që i lindin nga ligjet në fuqi IP duhet të bashkëpunojë ngushtë me disa institucione apo struktura që kanë ndikim direkt ose indirekt në mbarëvajtjen e këtij procesi. Këto institucione apo struktura janë: Policia e Shtetit, Organet Tatimore dhe Doganore, Policia Bashkiake, Roja Bregdetare, Kapiteneria e Porteve, QNOD-në, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si dhe çdo autoritet tjetër përgjegjës⁵⁵.

Për një mbulim më të mirë me kontroll dhe inspektim të sektorit, DSHPA ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit në nëntor të vitit 2018 *"Për disiplinimin, parandalimin dhe bllokimin e aktivitetit të paligjshëm të Peshkimit dhe Akuakulturës në ujërat detare, territoriale dhe të brendshme në Republikën e Shqipërisë"*.

Bashkëpunimi me Policinë Kufitare dhe Rojen Bregdetare është domethënës në kontrollin e aktivitetit të paligjshëm të peshkimit. IP nuk ka marrëveshje formale me këto dy struktura por rezulton që të ketë bashkëpunim për sa i përket sinjalizimit për peshkim të paligjshëm. Më saktësisht janë këto dy struktura që në mungesë të sistemit të monitorimit i cili duhet të jetë i instaluar në anijet e peshkimit me gjatësi mbi 12 metra, ndihmojnë QNOD-në në rastet e lindjes së dyshimeve për peshkim të paligjshëm, pa regjistruar dhe pa raportuar.

Pranë Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare, MBZHR/DSHPA ka sektorin e saj që është përgjegjës për monitorimin e peshkimit në nivel kombëtar.

QNOD-ja mbikëqyr hapësirën detare shqiptare nëpërmjet⁵⁶:

- vëzhgimit të anijeve të peshkimit nga anijet e inspektimit ose mjete të tjera mbikëqyrëse;
- sistemit të monitorimit;
- çdo metode tjetër zbulimi apo identifikimi;

Në zbatim të detyrimeve ligjore që iu lindin nga ligji për peshkimin, anijet e peshkimit me gjatësi të barabartë ose më të madhe se 12 metra duhet të instalojnë në bordin e

VKM 407, datë 08.05.2013 "Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregulave të politikave menaxhuese në peshkim", i ndryshuar;

VKM nr. 302, datë 10.04.2013 "Për ngritjen e Sistemit të Inspektimit për parandalimin, shkurajimin dhe eliminimin e peshkimit të Paligjshëm, të Parregjistruar dhe të Paraportuar (PPP) dhe krijimin e skemë së certifikimit të zënieve në peshkim";

Rregullore e Brendshme të DSHPA-së.

⁵⁵Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin" i ndryshuar, neni 122, pika 5

⁵⁶Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin" i ndryshuar, neni 71,

tyre pajisjen përkatëse që mundëson identifikimin dhe lokalizimin e tyre automatik, të menjëhershëm, në intervale të caktuara dhe të rregullta kohore, nëpërmjet transmetimit të të dhënave për vendndodhjen përkatëse në sistemin satelitor⁵⁷.

Sistemi i monitorimit të anijeve të peshkimit shërben që QNOD të monitorojë aktivitetin e anijeve që ai të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu nëpërmjet këtij sistemi anijet e peshkimit me gjatësi të barabartë ose më të madhe se 12 metra regjistrojnë në rrugë elektronike të dhënat e librit të anijes së peshkimit (Logbook). Ky libër përmban në mënyrë specifike të gjitha sasinë për secilin lloj të zënë dhe të mbajtur në bord, dhe ky informacion i dërgohet QNOD-së të paktën një herë në 24 orë⁵⁸. Pajisjet për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, të instaluar në bordin e anijeve të peshkimit, garantojnë transmetimin automatik në QNOD, me intervale të rregullta, të paktën një herë në dy orë, të të dhënave të mëposhtme⁵⁹:

- Identifikimin e anijes së peshkimit;
- Pozicionimin e fundit gjeografik të anijes së peshkimit;
- Datën dhe orën në të cilën është identifikuar pozicioni i anijes;
- Shpejtësinë e momentit dhe kursin e anijes.

Pra sistemi i monitorimit të anijeve të peshkimit është mjete i vetëm që bën të mundur monitorimin e aktivitetit të anijeve të peshkimit, identifikimin e lëvizjes së anijeve dhe komunikimin elektronik të tyre, monitorimin e peshkimit të paligjshëm, pa regjistruar dhe pa raportuar, regjistrimin dhe transmetimin e të dhënave në format elektronik, duke bërë të mundur funksionim si duhet të sistemit të kontrollit për zbatimin e kuadrit ligjor për peshkimin dhe për të marrë masa për një shfrytëzim dhe zhvillim të qëndrueshëm të burimeve peshkore.

Në një auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të ushtruar nga KLSH në MBZHR në vitin 2017, janë konstatuar parregullsi në procedurat për prokurimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit të monitorimit Blue-Box. KLSH ka konstatuar se në dokumentet e tenderit dhe të ofertave, nuk është bërë ndarja e shpenzimeve në kosto operacionale dhe kosto mirëmbajtje. Ndarja në dy pjesë e shpenzimeve është kërkesë e ligjit nr. 64/2012 "Për Peshkimin"⁶⁰. Ky detyrim ligjor nuk është përmbushur nga MBZHR dhe pasi KLSH e ka konstatuar si shkelje, sistemi i monitorimit të anijeve të peshkimit (BlueBox) nuk ka funksionuar më. MBZHR nuk ka përmbushur detyrimet që i ngarkon legjislacioni i peshkimit që të sigurohet që asnjë anije peshkimi me gjatësi të barabartë ose më të madhe se 12 metra të mos zhvillojë aktivitet pa qenë e pajisur me pajisjen përkatëse të identifikimit dhe lokalizimit automatik⁶¹. Sipas një raportit mediatik në vendin tonë kryhet peshkim i paligjshëm në

⁵⁷Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin" i ndryshuar, neni 72

⁵⁸Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin" i ndryshuar, neni 74,77

⁵⁹VKM 407, datë 08.05.2013 "Për Përcaktimin e një Regjimi Kontrolli për të Garantuar Respektimin e Rregullave të Politikave Menaxhuese në Peshkim", e ndryshuar

⁶⁰Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin" i ndryshuar, neni 72:

Kostot e transmetimit satelitor apo mesazheve me sistemet e tjera të anijeve të peshkimit mbulohen nga vetë anijet e peshkimit. Kostoja e lidhjes së QNOD-së me sistemin satelitor mbulohet nga ministria.

⁶¹Ligji nr. 64/2012 "Për Peshkimin", i ndryshuar, neni 72

kundërshtim me kërkesat e legjislacionit duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në mjedisin detar⁶².

Nuk rezulton që nga MBZHR të jenë bërë përpjekje për të zgjidhur këtë problem i cili nis në vitin 2017. Iniciativat e para nga MBZHR janë marrë në vitin 2019, por çështja ende sot është e pazgjidhur pasi MBZHR ka kundërshtuar vlerat e fondit limit të përllogaritura nga AKSHI duke i klasifikuar ato si shumë të larta. Vlen të theksohet se anijet e peshkimit vazhdojnë aktivitetin e tyre normalisht duke mos pasur asnjë mundësi kontrolli nga autoritetet përkatëse.

QNOD/Spektori i mbikëqyrjes së aktivitetit të peshkimit ka në përbërje 6 punonjës (1 Përgjegjës Spektori dhe 5 specialistë) të cilët punojnë 24/7. Për monitorimin e aktivitetit të anijeve të peshkimit specialistët bazohen në eksperiencën e tyre dhe në bashkëpunimin e ngushtë me Rojen Bregdetare dhe Policinë Kufitare. Në mungesë të sistemit anijet e peshkimit nuk mund të gjurmohen dhe lokalizohen por nga sistemi i monitorimit të radarëve (SIVD) specialistët përpiqen të identifikojnë lëvizjet e mjeteve në përgjithësi pra vendndodhjen në det, lëvizjet e pazakonta dhe shpejtësinë. Në rastet kur lindin dyshime për aktivitetin e një mjeti, si fillim komunikohet në radio me kapitenin për të dhënë sqarime, më pas mund ti kërkohej të kthehet menjëherë në port por ka dhe raste kur shoqërohet nga Roja Bregdetare/Policia Kufitare. Me kthimin në port ky mjet nuk lejohet të shkarkojë zëniet pa ardhur inspektorët e peshkimit të cilët janë njoftuar me email menjëherë në momentin e konstatimit të dyshimit.

Spektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit (njohur si Inspektorati i Peshkimit) si strukturë e DSHPA-së ka në përbërje 24 inspektorë të cilët janë të ndarë sipas qarqeve, nga dy inspektorë në çdo qark. Por rezulton se në realitet kemi disa qarqe me nga një inspektor si p.sh qarqet Dibër, Kukës, Gjirokastër dhe Shkodër. Bazuar në rregullat dhe mënyrën online të inspektimeve që ka të miratuar IQ, për të kryer një inspektim (për të krijuar një çështje në sistemin online të inspektimeve) duhen të paktën dy inspektorë. Inspektorët punojnë në orarin zyrtar 8:00-16:30 e hënë-e enjte, 8:00-14:00 të premten. Këto inspektorë duhet të mbulojnë me inspektim dhe kontroll të gjithë sipërfaqen (vijë bregdetare, ujëra të brendshme) të gjithë territorin dhe të gjithë zinxhirin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës. Vendi ynë ka një vijë bregdetare prej 430 km e cila është e ndarë në:

- Porti Shëngjin 85 km, nga grykëderdhja e Bunës deri në kepin e Rodonit;
- Porti Durrës 90 km, nga Kepi i Rodonit deri në Divjakë;
- Bregdeti Fier 45 km, nga Divjaka deri në grykëderdhjen e Vjosës;
- Porti Vlorë 140 km, nga grykëderdhja e Vjosës deri në Himarë;
- Porti Sarandë-Himarë 70 km, nga Himara deri në kepin e Stillos.

Për të kryer inspektimet IP ka në dispozicion 4 mjete ujore dhe 6 mjete tokësore. Për kryerjen e këtyre kontrolleve kur lind nevoja IP kërkon ndihmën dhe mbështetjen e Rojes Bregdetare dhe Policisë së Kufirit dhe Emigracionit.

Për ushtrimin e detyrave të tyre inspektorët bazohen në rregulloren e brendshme të DSHPA-së. MBZHR/DSHPA duhet të ketë të miratuar rregulloren dhe manualin që të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorëve të peshkimit në bashkëpunim me

⁶²<https://www.youtube.com/watch?v=wwjIFkflhz8>

Inspektoratin Qendror⁶³.

Vëzhguesit dhe monitoruesit janë dy struktura të cilat duhet të japin kontributin e tyre në të gjithë procesin e monitorimit, vëzhgimit, kontrollit inspektimit dhe mbikëqyrjes së aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës.

“Vëzhguesit” miratohen nga Ministri si pjesë e strukturave të ministrisë, institucioneve të varësisë apo enteve kërkimore publike e private. Detyra e tyre është që të vëzhgojnë zëniet, trajtimin dhe përpunimin e burimeve ujore si dhe të grumbullojnë dhe regjistrojnë të dhënat lidhur me këtë veprimtari, informacion biologjik apo informacione të tjera të lidhura me aktivitetin e peshkimit⁶⁴.

“Monitoruesit” janë pjesë e strukturës së ministrisë dhe mbledhin informacione apo statistika, siç kërkohet nga Drejtoria e Peshkimit, në përputhje me kërkesat e Komisionit European dhe Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, sipas specifikimeve të programit kombëtar për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave⁶⁵.

Baza aktuale e të dhënave është një skedar “excel” i cili është krijuar nga inspektorët e peshkimit. Hedhja e të dhënave në të bëhet nga të paktën tre persona dhe nuk ka asnjë metodologji, kontroll apo rregull që të sigurojë saktësinë e këtyre të dhënave. Procesi i mbledhjes së të dhënave nga inspektorët e peshkimit, bëhet referuar librave të vetë deklarimit të subjekteve peshkore (Logbook) dhe mbledhjes së të dhënave për ujërat e brendshme. Pra të dhënat mbi zëniet merren vetëm nga vetë deklaratimet dhe në disa raste IP bën një kontroll të dyfishtë mbi saktësinë e tyre që është kryesisht krahasim i Logbook me faturën tatimore që marrin subjektet peshkore kur shesin sasinë e zënë në subjektet e grumbullimit dhe tregtimit të peshkut. Të dhënat e mbledhura nga inspektorët e DSHPA përpunohen dhe përcillen në MBZHR. MBZHR këto të dhëna i përcjell në INSTAT. Grupi i auditimit grumbulloi të dhëna mbi zëniet e peshkut për periudhën objekt auditimi si nga DSHPA ashtu edhe nga MBZHR.

Tabela 7: Krahasim i të dhënave të sasive të zënieve DSHPA-MBZHR/INSTAT

Emërtimi	2016		2017		2018	
	DSHPA MBZHR	INSTAT	DSHPA MBZHR	INSTAT	DSHPA MBZHR	INSTAT
Detar	2830	4646	2553	4609	5537.2	5537
Bregdetar	580	952	595	1074	315.3	315
Laguna	364	598	330	599	349.5	350
Ujëra të brendshme	532	1688	460	2007	2427	2427
Akuakultura	604	3200	1050	4000	5137.9	5138
Molosqe	302	1450	430	430	1108	1108
Totali në ton	5212	12534	5418	12719	14874.9	14875

Burimi: MBZHR dhe DSHPA. Punoi: Grupi i auditimit

⁶³Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin” i ndryshuar, neni 121

⁶⁴Ligji nr. 80/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012, “Për Peshkimin”, i ndryshuar

⁶⁵Ligji nr. 64/2012 “Për Peshkimin” i ndryshuar, neni 93

Nga të dhënat e shqyrtuara të marra nga IP rezulton se për vitet 2016-2018 numri i masave të ndryshme që ka dhënë inspektorati janë 172.

Vërehet se këto masa janë kryesisht për zhvillimin e aktivitetit të gjuetisë së paligjshme, peshkimit të pa rregulluar dhe pa raportuar si dhe mos deklarim i sasisë së zënieve. Pra mund të themi që mos zbatimi i legjislacionit mbetet ende një nga problemet kryesore të peshkimit dhe akuakulturës.

Tabela 8: Masat e dhëna nga Inspektorati i Kontrollit të Peshkimit sipas llojit të shkeljeve për vitet 2016-2018

Viti	Gjueti e paligjshme	Mos deklarimi librit të zënies	Aktiviteti i pa ligjshmëm (akuakulturë)	Gjueti pa licencë	Specie të ndaluara	Peshkim i paligjshëm, i parregulluar dhe i pa raportuar (PPP)
2016	42	16	0	0	0	0
2017	40	2	1	1	0	0
2018	26	20	1	0	2	21
TOTAL	108	38	2	1	2	21

Punoi: Grupi i auditimit. Të dhënat DSHPA/IP

Gjithashtu nga shqyrtimi i të dhënave të marra nga QNOD rezulton që për periudhën 2016-2018, 170 operacione janë të klasifikuara si të dyshuara për peshkim të paligjshëm. Pas verifikimeve të bëra nga Inspektorati i Peshkimit nga 172 raste të dyshuara, 108 kanë rezultuar gjueti e paligjshme-me shkelje të ligjit 64/2012 “Për Peshkimin”.

Në përfundim të shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha dokumenteve që grupi i auditimit grumbulloi, zhvillimit të intervistave të strukturuar, realizimit të pyetësorëve me stafin e subjekteve nën auditim dhe palët e interesit konkluduar në gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet si më poshtë.

Gjetje:

1. MBZHR nuk ka të miratuar manualin e detyrave dhe përgjegjësive të inspektorëve për peshkimin.
2. MBZHR në kundërshtim me Ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, neni 72, pika 9, lejon që anijet e peshkimit të kryejnë aktivitetin e peshkimit pa qenë të pajisura me pajisjen përkatëse të identifikimit dhe lokalizimit automatik.
3. QNOD e ka të pamundur të kryejë vëzhgimin e aktivitetit të anijeve të peshkimit, identifikimin dhe lokalizimin e tyre automatik pasi anijet e peshkimit nuk mund të transmetojnë automatikisht të dhënat mbi identifikimin, pozicionimin e fundit gjeografik, datën dhe orën e pozicionit, shpejtësinë dhe kursin e anijes dhe të dhënat mbi të gjitha sasisë për secilin lloj të zënë dhe të mbajtur në bord.
4. IP nuk mund të kontrollojë peshkimin e paligjshëm, të paregjistruar dhe të pa raportuar.

5. Aktiviteti i peshkimit dhe akuakulturës nuk monitorohet me inspektim dhe kontroll 24/7.
6. DSHPA/IP nuk zotëron mjete logjistike bashkëkohore që të bëjnë të mundur kryerjen me sukses të kontrolleve nga ana e inspektorëve.
7. IP kryen inspektime bazuar në "Planin vjetor të inspektimit të miratuar nga MBZHR" i cili nuk hartohet sipas një metodologjie të caktuar.
8. Për periudhën 2016-2018, MBZHR nuk ka patur një Program Kombëtar të miratuar me VKM për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave.⁶⁶
9. Për periudhën 2016-2018 kanë munguar "vëzhguesit" dhe "monitoruesit" të cilët janë strukturat përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave të ndryshme referuar Ligjit nr. 80/2017, neni 125.
10. DSHPA/IP ka vetëm një lloj formati standard të inspektimeve (proces-verbal) i miratuar nga IQ, pra nuk ka formate të ndryshme sipas llojeve të inspektimeve.
11. Të dhënat e MBZHR-së dhe INSTAT-it mbi sasinë e zënieve sipas kategorive të peshkut nuk përputhen.
12. Inspektorët e DSHPA plotësojnë proces-verbale pa qenë vetë prezent në momentin e konstatimit të shkeljes, duke u bazuar në konstatime të bëra nga palë të tjera.

Konkluzione:

1. Manuali i detyrave dhe përgjegjësi të inspektorëve për peshkimin është një dokument që u vjen në ndihmë inspektorëve lidhur me procesin e inspektimit dhe kontrollit të peshkimit. Ai do të bëjë të mundur që inspektorët të kryejnë më lehtë punën e tyre dhe performanca e tyre të jetë më e mirë duke hartuar raportet përkatëse të standardizuara dhe të bazuara në kërkesat e përcaktuara nga ministria. Mungesa e këtij manuali kufizon dhe cenon efektivitetin e procesit inspektues të IP.
2. Mungesa e sistemit të monitorimit të anijeve të peshkimit bën të pa mundur:
 - monitorimin e aktivitetit të anijeve të peshkimit;
 - identifikimin e lëvizjes së anijeve dhe komunikimin elektronik të tyre;
 - monitorimin e peshkimit të paligjshëm, pa regjistruar dhe pa raportuar;
 - regjistrimin dhe transmetimin e të dhënave në format elektronik.
 Në këtë situatë, strukturat përgjegjëse në MBZHR (QNOD dhe IP) e kanë të pamundur të përmbushin me efektivitet detyrat e tyre. Mungesa e sistemit të sinjalizimit satelitor rrezikon të mbyllë eksportet e peshkut për Shqipërinë, duke e klasifikuar aktivitetin e peshkimit si të paligjshëm, pa regjistruar dhe parregulluar.
3. IP nuk ka burime njerëzore të mjaftueshme dhe mjete logjistike të përshtatshme e bashkëkohore për të inspektuar të gjithë vijën bregdetare që ka vendi ynë, sipërfaqen e ujërave të brendshme dhe zinxhirin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës (inspektim në det, në port, në pikat e grumbullimit dhe tregtimit të produkteve peshkore). Mos prania e inspektorëve në momentin e kthimit të anijeve të peshkimit rezulton në mos verifikim të dimensioneve të peshqve, mos

⁶⁶ Ligji 64/2012, "Për peshkimin" neni 93, i ndryshuar.

verifikimin e zonës së gjuetisë apo shkeljeve të tjera të legjislacionit të peshkimit. E gjithë kjo problematikë sjell që aktiviteti i IP të mos jetë eficient.

4. Inspektimi i bazuar në një plan vjetor të hartuar pa një metodologji të caktuar cenon efektivitetin e IP në të gjithë procesin e inspektimit.
5. Programi kombëtar shumëvjeçar për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave biologjike, teknike, mjedisore dhe social - ekonomike krijohet në bazë të metodologjisë së miratuar nga ministri dhe të plotësuar me rregulla të rëndësishme ndërkombëtare dhe miratohet me VKM. Në Vendimin nr. 301 datë 10.04.2013 pika 2 dhe 3⁶⁷ është përcaktuar se Programi Kombëtar ka mbuluar 2013-2015. **Periudha objekt auditimi 2016-2018 është e pa mbuluar me një Program Kombëtar të miratuar me VKM.** Me VKM nr. 256 datë 24.04.2019 "Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për strategjinë kombëtare të peshkimit" janë përcaktuar rregullat për grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave.
6. Vëzhguesit dhe monitoruesit kanë detyra dhe përgjegjësi të ndryshme që burojnë respektivisht nga Ligji nr. 64/2012 "Për peshkimin", i ndryshuar, neni 125, pika 2,3 dhe 4. Mungesa e tyre cenon eficientësinë e aktivitetit të vëzhgimit dhe monitorimit përkatësisht, vëzhgimin e zënies së peshkut dhe grumbullimin si dhe marrjen e informacioneve e statistikave të ndryshme që duhen raportuar DSHPA-së.
7. Procesi i raportimit dhe publikimit të të dhënave lidhur me kategoritë e zënies së peshkut nuk është eficient, ka pasaktësi dhe nuk përputhet midis vet institucioneve përgjegjëse për të. DSHPA raporton të dhënat e zënies së peshkut në MBZHR e cila më pas i raporton në INSTAT. Bazuar edhe në tabelën nr. 7 të dhënat e INSTAT-it nuk përputhen me të dhënat që MBZHR ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit për periudhën objekt auditimi.
8. DSHPA/IP nuk mund t'i klasifikojë inspektimet sipas llojit të tyre (për shembull sa inspektime kryhen në ujëra, në tokë apo në pikat e shitjes) duke qenë se kanë vetëm një model të formularit të inspektimit. Kjo sjellë që procesi i raportimit të jetë jo i saktë, jo eficient dhe jo efektiv.
9. Në analizën vjetore të DSHPA-së të vitit 2016 është theksuar se inspektorët e DSHPA plotësojnë proces verbale pa qenë prezent në kohë reale në inspektim. Në disa raste ata bazohen në konstatime të bëra nga struktura të tjera si Policia Kufitare apo Roja Bregdetare dhe plotësojnë këto proces-verbale pa qenë vetë në inspektim duke treguar mungesë profesionalizmi, pa përgjegjshmëri dhe duke ulur efektivitetin e punës së tyre.

Rekomandime:

1. MBZHR të marrë masa për të hartuar dhe miratuar manualin e detyrave dhe përgjegjësi të inspektorëve për peshkimin si një dokument që asiston inspektorët lidhur me procesin e inspektimit.

Qershor 2020

⁶⁷ Vendim nr. 301 datë 10.04.2013 "Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për Strategjinë Kombëtare të Peshkimit.

2. MBZHR të ndjekë me prioritet dhe të angazhohet maksimalisht për pajisjen e anijeve të peshkimit me sistemin e sinjalizimit satelitor.

Mars 2020

3. DSHPA/MBZHR të marrë masat e nevojshme për të shtuar numrin e inspektorëve me qëllim mbulimin me kontroll dhe inspektim të aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës 24/7.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. DSHPA nëpërmjet MBZHR-së të marrë masa për të përmirësuar mjetet logjistike që duhet të ketë në dispozicion gjatë inspektimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. DSHPA/IP të përgatisin Planin Vjetor të Inspektimeve, kontrolleve duke u bazuar në një metodologji që mbështetet në vlerësimin e riskut, fondet, mjetet dhe burimet njerëzore në dispozicion.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. MBZHR të marrë masa për të ngritur strukturat e "vëzhguesit" dhe "monitoruesit" në përputhje me Ligjin nr. 64/2012, neni 125 i ndryshuar.

Qershor 2020

7. DSHPA/IP të përgatisë dhe të miratojë formate të inspektimit bazuar në llojet e inspektimeve (inspektim në ujëra, në tokë apo në pikat e shitjes) që kryen me qëllim që të dhënat të grupohen sipas llojeve të inspektimeve.

Mars 2020

8. MBZHR në bashkëpunim me INSTAT të rishikojë të dhënat lidhur me sasinë e zënies së peshkut sipas kategorive të llojeve të ndryshme të peshkut me qëllim shmangien e mospërputhjeve në këto të dhëna.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. DSHPA të marrë masa që asnjë inspektor të mos plotësojë dhe firmosë proces-verbale pa qenë vetë prezent në momentin e konstatimit të shkeljes.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.4 A menaxhohen në mënyrë efektive infrastrukturat e lidhura me veprimtarinë e peshkimit dhe akuakulturës?

3.4.1 A është efektiv menaxhimi i porteve nga OMP-të krahasuar me menaxhimin nga DSHPA, dhe a zbatohet marrëveshja e nënshkruar me MBZHR-në (DSHPA-në) për këtë menaxhim?

Mbështetur në ligjin nr. 64/2012 "Për Peshkimin", i ndryshuar, përcaktimi i formave të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit bëhet me Udhëzim të Ministrit, i cili vendos rast pas rasti për mënyrën e menaxhimit të çdo porti peshkimi ose infrastrukture të lidhura me veprimtarinë e peshkimit, pas marrjes së mendimit edhe të KKQPA-së⁶⁸. Pasi përcaktohet nga Ministri mënyra e menaxhimit të porteve dhe infrastrukturave të peshkimit është përgjegjësi e DSHPA-së të menaxhojë infrastrukturën e peshkimit në një nga mënyrat e përcaktuara në ligj siç janë⁶⁹:

- menaxhim i drejtpërdrejte;
- menaxhim nëpërmjet Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit (OMP);

⁶⁸Ligjin nr. 64/2017 "Për peshkimin", i ndryshuar, neni 65, pika 2

⁶⁹Ligjin nr. 64/2017 "Për peshkimin", i ndryshuar, neni 65, pika 3, neni 66, pika 2 dhe pika 3

- menaxhim nga subjektet private;
- menaxhim i kombinuar.

Një ndër mënyrat e menaxhimit të sipër përmendura është menaxhimi nga Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit. OMP janë persona juridikë privatë që krijohen me nismën e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në statutin e tyre. Anëtarët e organizatës së peshkimit janë pronarë dhe/ose anëtarë jo pronarë të anijeve të aktivitetit të peshkimit, sipas vendit ku ai ushtrohet⁷⁰. Sipas legjislacionit në fuqi infrastrukturat e peshkimit mund tu jepen në menaxhim OMP bazuar në mendimin e KKPQPA-së⁷¹. KKQPA kryesohet nga Ministri dhe ka në përbërje drejtorë të drejtorive të ministrisë, përfaqësues të organizatave më të mëdha të menaxhimit dhe të prodhuesve të peshkimit, si dhe ekspertë në lëmin e peshkimit, akuakulturës dhe mjedisit⁷². Ministri duhet të mbledhë komisionin jo më pak se një herë në vit⁷³. DSHPA ka në menaxhim 4 portet e peshkimit: porti i peshkimit Shëngjin, Sarandë, Vlorë dhe Durrës. Për periudhën objekt auditimi këto porte kanë qenë në menaxhim në mënyrat si më poshtë:

- Porti i peshkimit Durrës duke filluar që nga viti 2004 është në menaxhim nga OMP Durrës bazuar në marrëveshjen përkatëse⁷⁴.
- Porti i peshkimit Shëngjin deri në vitin 2015 është menaxhuar nga OMP Shëngjin sipas marrëveshjes përkatëse⁷⁵. Me kërkesa të DSHPA-së⁷⁶ dhe me urdhër të Ministrit është vendosur që të merret nga OMP dhe t'i kalojë në ruajtje DSHPA-së⁷⁷.
- Porti i peshkimit Vlorë është menaxhuar nga OMP Vlorë sipas marrëveshjes përkatëse⁷⁸. Me kërkesë të DSHPA-së⁷⁹ dhe me urdhër të Ministrit është vendosur që të merret nga OMP dhe t'i kalojë në ruajtje DSHPA-së⁸⁰.
- Porti i peshkimit Sarandë deri në vitin 2014 është menaxhuar nga OMP Sarandë sipas marrëveshjes përkatëse. Me kërkesën e DSHPA-së⁸¹ dhe me urdhër të Ministrit është vendosur që të merret nga OMP dhe t'i kalojë në ruajtje DSHPA-së⁸².

Pra për periudhën objekt auditimi DSHPA ka menaxhuar/ruajtur portet e peshkimit Shëngjin dhe Sarandë ndërsa portet e peshkimit Durrës dhe Vlorë janë menaxhuar nga OMP-të përkatëse. DSHPA vazhdimisht ka ngritur shqetësimin e saj lidhur me gjendjen

⁷⁰Ligjinr 64/2017 "Për peshkimin", i ndryshuar, neni 58

⁷¹Ligjinr 64/2017 "Për peshkimin", i ndryshuar, neni 65, pika 2

⁷²Ligjinr 64/2017 "Për peshkimin", i ndryshuar, neni 21, pika 2

⁷³Ligjinr 64/2017 "Për peshkimin", i ndryshuar, neni 21, pika 5

⁷⁴Marrëveshja për transferimin në përdorim të portit të peshkimit Durrës, datë 3.12.2004 porti i vjetër. Marrëveshja nr. 35/1 Prot. datë 26.01.2019. Urdhër nr. 1303 Prot. datë 05.02.2019 porti i ri.

⁷⁵Marrëveshja për transferimin në përdorim të portit të peshkimit Shëngjin, datë 21.02.2005

⁷⁶Shkresa nr. 267, datë 06.11.2014 dhe nr. 9 Prot, datë 12.01.2015

⁷⁷Urdhër nr. 5244 Prot. datë 19.06.2015

⁷⁸Marrëveshja për transferimin në përdorim të portit të peshkimit Vlorë, datë 21.02.2005

⁷⁹Shkresa nr. 4420, datë 22.05.2015

⁸⁰Urdhër nr. 5244 Prot. datë 19.06.2015

⁸¹Shkresa nr. 105 Prot. datë 28.04.2014

⁸²Urdhër nr. 3197 Prot. datë 05.05.2014

e porteve të peshkimit duke kërkuar mbështetjen dhe ndërhyrjen e MBZHR-së për të marrë në menaxhim portet e peshkimit siç e përcakton ligji 64/2012 "Për peshkimin", i ndryshuar neni 65, pika 3/a⁸³.

OMP-të që kanë menaxhuar portet e peshkimit kanë pasur probleme midis anëtarëve dhe nuk kanë funksionuar si duhet. Kjo problematikë ka ndikuar në menaxhimin e porteve nga ana e tyre, duke rënduar edhe më shumë situatën në këto infrastruktura⁸⁴. Në zbatim të marrëveshjeve të nënshkruara me DSHPA-në, OMP-të kanë për detyrë ndër të tjera të krijojnë kushtet për përpunimin e anijeve të peshkimit në port (shkarkimin e sasisë së zënë, furnizimin me karburant, energji, ujë etj), të krijojnë kushtet për shërbimet e nevojshme të anijeve të peshkimit, vendosjen e sigurte të anijeve të peshkimit në kalata etj⁸⁵. Kjo marrëveshje tip me afat 30 vjeçar e miratuar me VKM nr. 151, datë 13.03.2003 ka qëndruar në fuqi deri në maj të vitit 2018 kur me Udhëzimin nr. 6, datë 07.05.2018 është miratuar Marrëveshja e re tip për menaxhimin e porteve të peshkimit nga OMP-të. Porti i ri i peshkimit Durrës që është marrë në menaxhim nga OMP Durrës është bërë me marrëveshjen e re e cila ka një afat deri në 20 vjet. Në këtë udhëzim gjithashtu përcaktohet se DSHPA menaxhon infrastrukturën e porteve të peshkimit bazuar në rregulloren e administrimit të porteve të peshkimit e cila miratohet nga ministri⁸⁶.

DSHPA duke u mbështetur në VKM-në nr. 719, datë 20.10.2011, e ndryshuar, pika 6 (DSHPA harton rregulloren e vet të funksionimit, ku përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përkrahjet e vendit të punës së çdo funksioni në këtë drejtori. Rregullorja miratohet nga Ministri) ka hartuar dhe ka përcjellë me shkresat nr. 223 Prot. dhe nr. 223/1 Prot. datë 28.09.2015 për miratim nga Ministri dy draft-rregullore: draft-Rregulloren e Brendshme të DSHPA-së dhe draft-Rregulloren e Administrimit të Porteve të Peshkimit. Nga Ministri i MBZHR-së është miratuar vetëm Rregullorja e Brendshme e DSHPA-së. Draft-Rregullorja e Administrimit të Porteve të Peshkimit nuk është miratuar dhe me shkresën nr. 7357/1 Prot. datë 21.10.2015 Ministria i kthen përgjigje DSHPA-së që kjo rregullore do të jetë pjesë e Rregullores së Brendshme të DSHPA-së. Rregullorja e Brendshme e DSHPA-së e miratuar nga Ministri në tetor të vitit 2015 në nenin 33 përcakton që si pjesë të kësaj rregulloreje janë:

- Rregullore mbi procedurat teknologjike dhe të funksionimit të qendrave në Sarandë, Pogradec dhe Korçë;
- Rregullore e Sektorit të Monitorimit dhe Kontrollit të Peshkimit;
- Rregullore e Administrimit të Sektorit të Peshkimit

DSHPA në mungesë të burimeve njerëzore dhe të fondeve, pas marrjes në dorëzim të porteve vetëm është përpjekur të pastrojë dhe të ruajë portet nga vjedhje të pajisjeve të ndryshme që ndodhen në porte.

Në analizat e saj vjetore 2016-2018 që DSHPA i paraqet Ministrisë janë ngritur problematikat me portet e peshkimit dhe gjendjen e tyre, janë trajtuar problemet me OMP-të që menaxhojnë portet e peshkimit dhe gjithashtu është kërkuar mbështetje

⁸³ Shkresat nr. 336 Prot. datë 28.10.2016 dhe nr.42 Prot. datë 02.02.2017

⁸⁴Analizat Vjetore të DSHPA-së 2016-2018

⁸⁵Marrëveshja për transferimin në përdorim të portit të peshkimit Durrës, datë 3.12.2004. Marrëveshja për transferimin në përdorim të portit të peshkimit Vlorë, datë 21.02.2005, neni 6, neni 10


⁸⁶Udhëzim nr.6, datë 07.05.2018, Kreu II, pika 2

nga ana e MBZHR-së për të zgjidhur këto çështje. Në shkresat dhe në analizat vjetore që DSHPA i drejton MBZHR ajo pretendon që roli i saj në mbikëqyrjen e marrëveshjes së menaxhimit të porteve të peshkimit nga OMP-të është i kufizuar “vëzhgim, inventarizim dhe informim periodik”. Në marrëveshjen tip me të cilën janë menaxhuar portet e peshkimit deri në marrjen në ruajtje nga DSHPA apo për portin e Durrësit deri në kalimin në portin e ri, nuk është e qartë përgjegjësia e DSHPA-së në monitorimin e zbatimit të kushteve të marrëveshjes. Por, DSHPA si një nga palët nënshkruese të marrëveshjes si dhe bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin” i ndryshuar, neni 65 dhe 66 është përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturave të peshkimit. Edhe pse DSHPA pretendon se ajo nuk ka autoritetin për të monitoruar marrëveshjen me OMP-të ajo vazhdimisht në analizat vjetore apo në shkresat e drejtuara MBZHR-së ka ngritur problematikat në këto porte.

Në Udhëzimin nr. 6, datë 07.05.2018 përcaktohet përgjegjësia e DSHPA-së në menaxhimin e porteve të peshkimit kur këto iu jepen në menaxhim OMP-ve. Ky udhëzim ka të bashkëlidhur edhe marrëveshjen tip që duhet të lidhet me OMP-të në rastin e marrjes në menaxhim të një infrastrukture peshkimi. Aktualisht me këtë marrëveshje të re në janar të vitit 2019 është marrë në menaxhim nga OMP Durrës porti i ri i peshkimit Durrës. Grupi auditimit nga shqyrtimi i evidencave, analizave vjetore të DSHPA-së 2016-2018 dhe nga vizitat në terren konstatoi një sërë problematikash me portet e peshkimit të cilat janë përmendur në vazhdim të këtij auditimi.

Porti i Peshkimit Shëngjin ka hapësirë të vogla ankoruese edhe pse me transferim kapitali është marrë bankina e ushtrisë nga ana e MBZHR/DSHPA nuk ka pasur investime për ta bërë atë funksionale. Mos pasja e hapësirave të nevojshme për ankorimin e të gjitha mjeteve të peshkimit bën që një pjesë e mjeteve të ankorohen në kalatat e portit detar Shëngjin duke u bërë shpeshherë burim konflikti midis palëve. Hapësira ankoruese në këtë port është e zënë nga anijet e mbytura (5 anije), anije të tjera jashtë përdorimit apo dhe një vinç i pranishëm në port. Nuk ofrohen shërbimet bazike për peshkatarët si furnizimi me ujë dhe drita apo magazinat frigoriferike. Në port nuk ka kantier për riparimin e anijeve të peshkimit.

Foto 1



Pamje nga Porti i Peshkimit Shëngjin (E.Vojka 2019)

Porti i peshkimit Sarandë ka gjithashtu kapacitete ankoruese të vogla dhe një pjesë e mjeteve të peshkimit ankorohen në hapësirat e portit detar. Problem në këtë port është heqja e anijeve jashtë përdorimit të cilat bëhen pengesë për ushtrimin e një aktiviteti normal. Nuk ofrohen shërbimet bazike për peshkatarët si furnizimi me ujë

dhe drita apo magazinat frigoriferike. Në port nuk ka kantier për riparimin e anijeve të peshkimit.

Foto 2



Pamje Porti i Peshkimit Sarandë (E.Vojka 2019)

Porti i peshkimit Durrës për periudhën objekt auditimi ka qenë në hapësirat e portit të vjetër, dhe në janar 2019 ka kaluar në hapësirat e portit të ri.

Në portin e vjetër nuk kishte hapësira të mjaftueshme për ankorimin e të gjitha mjeteve të peshkimit dhe një pjesë e tyre ankorohej në kalatat e portit detar Durrës. Infrastruktura në këtë port ishte tejet e amortizuar dhe e papastër. Mungonin ofrimi i shërbimeve bazike si furnizimi me ujë dhe drita apo magazinat frigoriferike. Në port nuk kishte hapësira për riparimin e anijeve të peshkimit.

Foto 3



Pamje nga Porti i vjetër i peshkimit Durrës (E.Vojka 2019)

Vlen për t'u theksuar se nga vizita në portin e ri të peshkimit Durrës si dhe nga biseda me peshkatarët që ankorohej në hapësirat e këtij porti edhe në portin e ri që është bërë funksional në fillim të vitit 2019 nuk është investuar në terma afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Përkatesisht ky port është në sipërfaqe më të vogël se porti i vjetër

duke e theksuar edhe më shumë mungesën e hapësirave të ankorimit, gjithashtu nuk ka kantier për riparimin e anijeve të peshkimit.

Foto 4



Anijet me përmasa të mëdha e kanë të pamundur të kryejnë edhe shërbimet bazë në hapësirat e portit siç mund të jetë qepja e rrjetave të peshkimit. Për ankorimin nuk ka një rregull të vendosur, si rezultat mund të bëhet burim konflikti midis peshkatarëve. Gjithashtu edhe në portin e ri peshkatarëve nuk ju ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë dhe drita në momentin e ankorimit.

Pamje nga riparimi i një mjete në portin e ri të peshkimit Durrës (E.Vojka 2019)

Porti i peshkimit Vlorë është porti më i madh në vend por infrastruktura e tij është po aq e dëmtuar sa edhe e porteve të tjera. Në këtë port hapësirat e ankorimit të mjeteve të peshkimit janë të zëna nga anijet turistike, nga anijet e mbytura dhe një pjesë e madhe e hapësirave të portit janë kthyer në parking për makinat e sekuestruara nga Policia Rrugore.

Foto 5



Pamje të makinave të sekuestruara nga Policia Rrugore dhe të parkuara në portin e Peshkimit Vlorë (E.Vojka 2019)

Foto 6



Pamje e një anije të mbytur, Porti i Peshkimit Vlorë (E.Vojka 2019)

Foto 7



Pamje të anijeve turistike në të ankoruara në Portin e Peshkimit Vlorë (E.Vojka 2019)

Edhe porti i peshkimit Vlorë vuan nga mungesa e ndriçimit, furnizimit me ujë dhe mungesa e magazinave frigoriferike në hapësirat e portit. Gjithashtu mungon kantieri për riparimin e anijeve.

Peshkatarët duhet të gjejnë në mënyrë individuale mundësitë e riparimit. Disa peshkatarë në pamundësi për të gjetur vend riparime përpiqen t'i riparojnë anijet në mënyrë artizanale në hapësirat e porteve, por kjo përbën dhe problematika pasi ka ankesa nga peshkatarët e tjerë. Një pjesë e tyre i riparojnë mjetet e peshkimit në bazën e Pashalimanit dhe një pjesë në kantieret e riparimit në vendet fqinje. E gjitha kjo përbën një problem madhor për zotëruesit e mjeteve të peshkimit duke pasur parasysh moshën e vjetër që ka flota jonë e peshkimit (mosha e flotës 40 vjeçare krahasuar me mesataren e BE-së prej 21 vjeçare)⁸⁷ dhe kostot që ka për peshkatarët riparimi i tyre.

Tabela 9: Të dhëna mbi sipërfaqen e porteve të peshkimit, flotën dhe kapacitetin

Porti	Sip m ²	Flota 2016	Flota 2017	Flota 2018	Kapaciteti aktual	Kapaciteti real	Anijet 20-25 m në Portin Detar
Shëngjin*	9,326	65	73	77	76		20
Vlorë	101,200	194	188	209	115	140	
Sarandë	4,404	97	94	111	39	32	
Durrës porti i vjetër	23,626	209	204	226	85		20
Durrës porti i ri	13,524				60		
Totali		565	559	623			

Burimi: MBZHR/DSHPA. Përpunoi: Grupi i auditimit

Shënim: Grupi i auditimit nuk ka siguruar të dhëna nga DSHPA lidhur me kapacitetin real të ankorimit të anijeve në portet e peshkimit Shëngjin dhe Durrës.

*Porti Shëngjin ka hapësira për ankorimin e 30 mjeteve të mëdha por aktualisht ankorohen vetëm 16 mjete të mëdha për arsye të anijeve të mbytura që zënë hapësirat.

⁸⁷Strategjia Kombëtare e Peshkimit 2016-2021, Kapitulli 1-kushtet aktuale

Tabela 10: Flota e peshkimit sipas llojeve

	2016	2017	2018
Llojet e anijeve	Numri	Numri	Numri
Trawlers/ Gjueti fundore	156	157	166
Seiners / Me rrethim	3	5	4
Purse seiners / Me rrethim	8	8	8
Dredgers / Draga	5	5	5
Gill netters / Me rrjeta	368	360	417
Multipurpose vessels Anije për disa lloj peshkimi	25	24	23
Totali mjete peshkimi	565	559	623

Burimi: MBZHR

Në përfundim të shqyrtimit dhe analizimit të gjitha dokumenteve që grupi i auditimit grumbulloi, zhvillimit të intervistave të strukturuar, realizimit të pyetësorëve me stafin e subjekteve nën auditim dhe palët e interesit, vizitat në infrastrukturën e peshkimit, konkludua në gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet si më poshtë.

Gjetje:

1. Urdhri i Ministrit të MBZHR nr. 215 datë 5.5.2014 “Mbi marrjen në ruajtje të Portit të Peshkimit Sarandë dhe Urdhri nr. 339 datë 10.6.2015 “Për marrjen në ruajtje të Porteve të Peshkimit Shëngjin dhe Vlorë” janë miratuar nga Ministri i MBZHR në kundërshtim me Ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, neni 65, pika 3.
2. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorja e Përgjithshme e Politikave në MBZHR dhe DSHPA nuk kanë zbatuar Urdhrin e Ministrit nr. 339 datë 10.6.2015 “Për marrjen në ruajtje të Portit të Peshkimit Vlorë.
3. Në Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të DSHPA-së që MBZHR ka miratuar, nuk është përfshirë “Menaxhimi i porteve të peshkimit”.
4. Për periudhën objekt auditimi nuk konstatohet që në portet e peshkimit që ka në menaxhim DSHPA/OMP të jenë bërë investime për përmirësimin e infrastrukturës së tyre.⁸⁸
5. OMP Durrës dhe Vlorë nuk kanë zbatuar kushtet e marrëveshjeve të nënshkruara me DSHPA-në për menaxhimin e porteve të peshkimit.
6. Në asnjë nga portet e peshkimit nuk ka kantier për riparimin e mjeteve të peshkimit, madje edhe në portin e ri të peshkimit Durrës nuk ekziston një kantier i tillë.
7. Në portet e peshkimit Shëngjin dhe Vlorë hapësirat e ankorimit janë të zëna nga anijet e mbytura.
8. Në portin e peshkimit Vlorë në vendet e ankorimit të mjeteve të peshkimit ankorohen anijet turistike.
9. Në hapësirat e portit të peshkimit Vlorë janë të parkuara makina të sekuestruara nga Policia Rrugore.
10. Asnjë nga portet e peshkimit nuk ka kapacitete për ankorimin e plotë të flotës së peshkimit.

⁸⁸ Sic është trajtuar edhe në Pyetjen e auditimit 3.1.2 i vetmi investim që është kryer është ndërtim i Portit të ri të peshkimit Durrës (Aneksi 1)

11. Asnjë nga portet e peshkimit nuk ofron kushtet minimale për peshkatarët siç janë furnizimi me energji, furnizimi me ujë, infrastrukturë të mirë si dhe mungojnë magazinat frigoriferike.
12. MBZHR nuk ka analizuar problematikat e ngritura nga DSHPA në analizat vjetore lidhur me problematikat e porteve të peshkimit dhe nuk ka hartuar një plan masash për zgjidhjen e tyre.

Konkluzione:

1. Në Ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, neni 65, pika 3 janë të përcaktuara mënyrat e menaxhimit të infrastrukturave të peshkimit dhe “marrja **në ruajtje** e porteve të peshkimit Sarandë, Shëngjin dhe Vlorë” nga DSHPA nuk është një nga format e përcaktuara në këtë ligj.
2. Në shkresën me nr. 42 Prot. datë 02.02.2017 dhe nr. 336 Prot. datë 28.10.2016 “Mbi marrjen në administrim të porteve të peshkimit” drejtuar Ministrit të MBZHR, DSHPA ngre problemin e mos administrimit të portit të peshkimit Vlorë. Në këto shkresa theksohet që OMP Vlorë nuk funksionon dhe porti i peshkimit ka mbetur në duart e ish Kryetarit të OMP-së i cili e menaxhon portin e peshkimit sipas interesave të tij private duke lejuar të ngrihen bankina pa leje nga subjekte të caktuara. Grupi i punës i ngritur nga Ministri për marrjen në dorëzim të portit Vlorë ka propozuar ndërprerjen e njëanshme të marrëveshjes me OMP-në Vlorë por kjo nuk është arritur. Kjo problematikë ka zgjatur me vite dhe në vitin 2019 ka dalë një tjetër urdhër i Ministrit për të marrë në dorëzim portin e peshkimit Vlorë.
3. Mos përfshirja e Rregullores për menaxhimin e porteve të peshkimit në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të DSHPA-së cenon efektivitetin e aktivitetit dhe mirë funksionimin e porteve të peshkimit.
4. Gjatë vizitave në terren që grupi i auditimit ka zhvilluar në të katër portet e marra si rast studimor ka dalë në pah mungesa e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës në periudhën objekt auditimi.
5. Kushtet e marrëveshjeve të nënshkruara midis OMP-ve Durrës dhe Vlorë me DSHPA-në nuk janë zbatuar pasi nuk është bërë ruajtja e objekteve me roje të specializuara, nuk janë mirëmbajtur ndërtesat e administratës dhe hapësirat ndihmëse dhe shpesh hapësirat e ankorimit të anijeve të peshkimit janë zënë me mjete të tjera. Menaxhimi i porteve të peshkimit rezulton jo efektiv, portet e menaxhuara nga OMP-të shfaqen me më shumë probleme krahasuar me portet që menaxhon DSHPA.
6. Flota e peshkimit e vendit tonë në përgjithësi është flotë e vjetër dhe kjo sjell nevojën për riparime të shpeshta. Mungesa e një kantieri në portet e peshkimit për riparimin e anijeve të peshkimit rrit koston për peshkatarët dhe rrjedhimisht për produktin përfundimtar që ato i ofrojnë konsumatorit final pasi ato janë të detyruar që për këtë shërbim të drejtohen në portet e vendeve fqinje.
7. Eficenca e gjithë aktivitetit të peshkimit cenohet nga mungesa e hapësirave ankoruese në të gjitha portet e peshkimit e cila sjell që një pjesë e mjeteve të peshkimit kryesisht anijet e mëdha të ankorohen në kalatat e porteve detare. Infrastruktura e dëmtuar dhe zënia e hapësirave nga anijet e mbytura apo mjetet turistike zvogëlon dukshëm hapësirat e ankorimit për mjetet e peshkimit.

8. Zënia e hapësirave të portit të peshkimit Vlorë nga makinat e sekuestruara shpeshherë përbën problem për sigurinë në port pasi persona të ndryshëm tentojnë të futen në hapësirat e portit për të vjedhur pjesë këmbimi të makinave të sekuestruara.
9. Mungesa e furnizimit me energji elektrike, furnizimit me ujë dhe magazinave frigoriferike ndikon në efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të peshkatarëve duke prekur drejtpërdrejtë cilësinë e produkteve peshkore.
10. Edhe pse shumë problematika janë ngritur nga DSHPA në analizat e saj vjetore duke iu adresuar MBZHR-së, MBZHR nuk ka marrë masat e mjaftueshme për zgjidhjen e këtyre problematikave.

Rekomandime:

1. Ministri i MBZHR të shfuqizojë Urdhrin me nr. 215 datë 5.5.2014 "Mbi marrjen në ruajtje të Portit të Peshkimit Sarandë dhe Urdhrin me nr. 339 datë 10.6.2015 "Për marrjen në ruajtje të Porteve të Peshkimit Shëngjin dhe Vlorë" dhe të përcaktojë format e menaxhimit të porteve me Udhëzim të Ministrit sipas mënyrave të përcaktuara në Ligjin nr. 64/2012 neni 65, pika 3, i ndryshuar.

Qershor 2020

2. DSHPA të hartojë dhe të dërgojë për miratim në MBZHR, "Rregulloren e Brendshme të Funkionimit" të saj ku si pjesë përbërëse të përfshijë edhe "Menaxhimin e porteve të peshkimit".

Mars 2020

3. DSHPA të propozojë në MBZHR rritjen e investimeve në portet e peshkimit Shëngjin, Sarandë dhe Vlorë duke realizuar një studim/analizë të situatës dhe nevojave aktuale të këtyre porteve duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet e KKQPA-së.

Qershor 2020

4. DSHPA të angazhohet dhe të marrë masa për zbatimin me përpikmëri të kushteve të marrëveshjes për menaxhimin e portit të peshkimit Durrës nga OMP Durrës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. MBZHR/DSHPA të marrin masa për ndërtimin e kantierëve të riparimit të anijeve në portet e peshkimit.

Dhjetor 2020

6. DSHPA/Spektori i Menaxhimit të Porteve të Peshkimit të hartojë dhe të paraqesë pranë MBZHR-së një plan veprimi për lirim të hapësirave nga anijet e mbytura në portet e peshkimit Shëngjin dhe Vlorë.

Mars 2020

7. DSHPA/ Spektori i Menaxhimit të Porteve të Peshkimit të marrë masa dhe të bëjë të mundur lirim të hapësirave ankoruese të portit të peshkimit Vlorë që janë të zëna nga anijet turistike.

Mars 2020

8. DSHPA/MBZHR të bashkëpunojë me Policinë Rrugore për të liruar hapësirat e zëna nga mjetet e sekuestruara në Portin e peshkimit Vlorë.

Prill 2020

9. MBZHR të marrë masa për përmirësimin e infrastrukturës në portet e peshkimit Shëngjin, Sarandë dhe Vlorë duke ofruar facilitetet bazë për peshkatarët siç janë furnizimi me energji elektrike, furnizimi me ujë, si dhe magazina frigoriferike për peshkatarët që operojnë në portet e peshkimit.

Dhjetor 2020

10. MBZHR të shqyrtojë me përgjegjshmëri problematikat e ngritura nga DSHPA në analizat vjetore të tyre lidhur me portet e peshkimit dhe të hartojë një plan masash për adresimin dhe zgjidhjen e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.4.2 A është efektiv menaxhimi i ekonomive të rasateve të koranit, krapit dhe QGDMS?

Ekonomia e rritjes së rasatit të Koranit në Lin - Pogradec.

Ekonomia e rritjes së rasatit të Koranit ndodhet në fshatin Lin të Pogradecit dhe është në administrim të DSHPA-së⁸⁹. Aktiviteti kryesor i kësaj ekonomie është rritja e rasatave të peshkut të Koranit me qëllim ripopullimin e liqenit të Ohrit. Teknologjia specifike që përdoret bën të mundur rritjen e rasateve në një cikël të mbyllur prej 10 muajsh.

Procesi i punës në këtë ekonomi fillon me grumbullimin dhe fekondimin e vezëve të koranit në muajt e parë të vitit, inkubimin e vezëve deri në çeljen e tyre (muajt Janar-Mars), trajtimin e vezëve të çelura (rasateve) në sallën e vaskave gjatë muajve Prill-Shtator, dhe hedhja e rasatit në liqenin e Ohrit në muajt Shtator-Tetor. Hedhja e rasatit bëhet në zona të caktuara nga punonjësit e qendrës, herët në mëngjes dhe mbasdite. Në këtë ekonomi rritje punohet 24/7.

Aktiviteti prodhues dhe mbarëvajtja e ekonomisë lidhet ngushtë me ndryshimet klimaterike. Kjo ekonomi në ushtrimin e aktivitetit të saj furnizohet me ujë nga një burim natyral që gjendet në afërsi të fshatit Lin, Pogradec. Ky burim furnizon me ujë edhe fshatin Lin. Mbarëvajtja e ekonomisë është e lidhur jetësisht me ujin e burimit. Kushtet atmosferike dhe ndërhyrjet në burim nga banorët e zonës kanë një ndikim të madh në furnizimin me ujë të ekonomisë. Punonjësit e ekonomisë janë përballur shpesh me situata të pakëndshme siç janë ndërhyrjet e banorëve në burim duke cenuar procesin e rritjes së rasatit, apo ndryshimi i parametrave të ujit të burimit si rezultat i faktorëve klimaterikë. Këto të fundit kanë bërë që në vitin 2018 rasati të hidhej në liqen më herët se periudha e duhur për të mos rrezikuar dëmtimin e tij në vaskat e rritjes. Për të mbajtur në monitorim cilësinë e ujit që furnizon ekonominë, nga ana e saj bëhen analizat e parametrave të ujit çdo muaj.

Tabela 11: Sasia e rasateve të prodhuara për vitet 2016-2018

Viti	Sasia e rasateve të prodhuara në copë
2016	650,000
2017	1,050,000
2018	980,000


⁸⁹VKM nr. 719, datë 201.10.2011; VKM Nr. 44, datë 29.1.2014

Foto 8



Pamje nga hedhja e rasatit të Koranit në liqenin e Ohrit (E.Vojka 2019)

Foto 9



Pamje nga Ekonomia e rritjes së Koranit – Lin Pogradec (E.Vojka 2019)

Ekonomia e rritjes së rasatit të Krapit në Zvezdë - Korçë.

Ekonomia e rritjes së rasateve të Krapit ndodhet në fshatin Zvezdë në Korçë dhe është në administrim nga DSHPA⁹⁰. Aktiviteti kryesor i kësaj ekonomie është rritja e rasatit të Koranit me qëllim ripopullimin e liqenit të Prespës. Kjo ekonomi ka një teknologji specifike në rritjen e rasatit të Krapit ku rasatet rriten në mënyrë artificiale me një cikël të mbyllur prej 10 muajsh. Proceset që kryhen janë: trajtimi i riprodhuesve dhe para riprodhuesve gjatë gjithë vitit, riprodhimi natyral në muajt Mars-Prill (kur temperaturat e ujit arrijnë 16-17C⁰), trajtim i rasatit në muajt Maj-Shtator, rrallim i rasatit në muajin Korrik dhe hedhja e rasatit në liqen gjatë muajve Shtator-Tetor. Procesi i lëshimit të rasateve kryhet në bashkëpunim me Inspektoratin e Peshkimit dhe OMP-në Korçë.

Numri i rasateve të prodhuara kushtëzohet nga shumë faktorë siç janë: kushtet klimaterike kryesisht ndryshimi i temperatura në ambient dhe furnizimi me ujë. Për ushtrimin e aktivitetit të saj ekonomia furnizohet me ujë nga diga e Zëmplakut me gjatësi 4.5 km. Kjo linjë nuk është direkte për furnizimin me ujë vetëm të ekonomisë

⁹⁰VKM nr. 719, datë 201.10.2011; VKM Nr. 44, datë 29.1.2014

por ajo furnizon të gjithë zonat përreth. Kjo bën që furnizimi me ujë i ekonomisë së mos jetë ai që nevojitet për zhvillimin e aktivitetit. Në afërsi të ekonomisë ndodhet një gurore e cila gjatë ushtrimit të aktivitetit (një nga proceset ishte dhe larja e betoniereve) shkarkonte ujin e ndotur në ekonominë e rritjes së Krapit. Kjo problematikë është ngritur nga punonjësit por pasi nuk ka gjetur zgjidhje, punonjësit janë angazhuar vetë në bashkëpunim me firmën private për të futur ujin në tubacione. Meqenëse kjo ekonomi procesin e rritjes së rasatit e ka në ambiente të hapura ecuria e këtij aktiviteti është e rrezikuar nga prania e grabitqarëve që dëmtojnë peshkun, si dhe nga ndotja e ujit me pesticide dhe kimikate që hidhen pranë kanalit të ujit. Kjo ekonomi ka një kapacitet prodhues prej 23 vaskash prodhimi, por aktualisht janë në kushte pune vetëm 13 prej tyre.


MBZHR ka filluar procedurat për ndërtimin e një pusi i cili do të përmirësonte problemin e furnizimit me ujë të vaskave por nuk parashikohen investime të tjera të cilat do të bënin të mundur rritjen e kapacitetit prodhues të qendrës. Kjo ekonomi prodhon mesatarisht 300 mijë rasate peshku në vit.

Tabela 12: Prodhimi i rasateve të Krapit për periudhën 2016-2018

Viti	Sasia e rasateve të prodhuar në copë
2016	321,000
2017	284,000
2018	309,000

Burimi: DSHPA

Foto 10



Pamje nga Ekonomia e Rritjes së Krapit në Zvezdë-Korçë (E.Vojka 2019)

Qendra e Grumbullimit dhe Depurimit të Midhjes, Sarandë (QGDM)

Qendra e Grumbullimit dhe Depurimit të Midhjes, Sarandë është në varësi të DSHPA-së⁹¹. QGDM është krijuar për të garantuar hedhjen në treg të produktit të midhjes konform kushteve higjeno-sanitare për të garantuar një produkt cilësor dhe të certifikuar për konsumatorët. Procesi i punës në këtë qendër fillon me marrjen e mostrave në Lagunën e Butrintit në bashkëpunim me AKU-në. Këto mostra dërgohen periodikisht në ISUV në zbatim të Planit të Monitorimit nr. 1412, datë 28.03.2013. Në përgjigjen zyrtare që ISUV dërgon në QGDM bëhet dhe klasifikimi i cilësisë së midhjes. Klasa A është e lejueshme për tu hedhur në treg për konsum, ky produkt etiketohet në

⁹¹VKM nr. 719, datë 201.10.2011; VKM Nr. 44, datë 29.1.2014

QGDM dhe shoqërohet me certifikatën përkatëse dhe hidhet në treg. Në rastet kur produkti klasifikohet si Klasa B atëherë ai i nënshtrohet procesit të depurimit në qendër. Në përfundim të procesit të depurimit, produkti i nënshtrohet analizave në laboratorët e autokontrollit në qendër dhe nëse nuk ka ngarkesa të larta mikrobiologjike ky produkt etiketohet dhe pajiset me certifikatën veterinare.

Në rast kur produkti i analizuar klasifikohet di Klasa C, hedhja e tij në treg është kategorikisht e ndaluar.

Sektori i Akuakulturës në DSHPA pasi merr përgjigjen e analizave të mostrave të dërguara në ISUV njofton menjëherë prodhuesit e midhjes mbi rezultat e analizave:

- Në rastin e klasifikimit në Klasën A për t'u pajisur me certifikatën veterinare.
- Në rastin e klasifikimit në Klasën B për të kaluar prodhimin në qendër për t'iu nënshtrohet procesit të depurimit.
- Në rastin e klasifikimit në Klasën C ndalimi i hedhjes në treg.

Të gjithë kultivuesit e midhjes mbështetur në kontratën që kanë me MBZHR për ushtrimin e aktivitetit duhet të kalojnë të gjithë sasinë e midhjes në QGDM si për klasën A ashtu edhe për Klasën B. Është e ndaluar që midhja të hidhet në treg pa qenë e pajisur me certifikatën veterinare. Për t'u siguruar që kjo gjë të mos ndodhë kryhen inspektime nga AKU dhe Inspektorati i Peshkimit duke verifikuar certifikatën e origjinës.


Tabela 13: Sasia e midhjeve të prodhuara kundrejt atyre që ka kaluar në QGDM për vitet 2016-2018

Viti	Sasia e prodhuar e midhjeve në ton	Sasia e midhjeve të kaluara në QGDM në ton	% e sasisë së kaluar në QGDM
2016	500	98.62	19.7%
2017	1500	21.70	1.4%
2018	953	92.45	9.7%

Të dhënat DSHPA

Siç mund të vërehet nga të dhënat në tabelën e mësipërme QGDM/DSHPA/MBZHR nuk kanë informacion se çfarë është bërë me sasinë tjetër të midhjeve që nuk ka kaluar në qendër për t'u pajisur me certifikatën veterinare dhe për t'u hedhur në treg. Gjithashtu mund të themi se prodhuesit kalojnë vetëm një sasi të vogël të prodhimit në qendrën e depurimit, pjesa tjetër hidhet në treg e pa certifikuar.

Foto 11



Pamje nga QGDM, Sarandë (E.Vojka 2019)

Gjetje:

1. Ekonomia e rritjes së Koranit në Lin nuk furnizohet mjaftueshëm me ujë për zhvillimin normal të aktivitetit të rritjes së Koranit.
2. Cilësia e ujit që furnizon ekonominë e rritjes së Koranit në Lin nuk është brenda normave dhe parametrave të duhura.
3. Ekonomia e rritjes së rasatit të Koranit në Lin nuk ka një mol për të ndihmuar punonjësit në periudhën e hedhjes së rasatit në liqenin e Ohrit.
4. Ekonomia e rritjes së rasatit të Krapit në Zvezdë nuk furnizohet mjaftueshëm me ujë për zhvillimin normal të aktivitetit të rritjes së Krapit.
5. Ekonomia e rritjes së rasatit të Krapit në Zvezdë nuk punon me kapacitet të plotë prodhimi.
6. Aktiviteti në Ekonominë e rritjes së rasatit të Krapit në Zvezdë është i rrezikuar nga prania e grabitqarëve (Vidrat/Lundërzat) si dhe nga uji i ndotur me pesticide dhe kimikate.
7. QGDM Sarandë ka kapacite të kufizuara të vaskave për kryerjen e procesit të depurimit dhe teknologji jo bashkëkohore.
8. QGDM/DSHPA/MBZHR nuk sigurojnë që të gjithë prodhuesit të kalojnë të gjithë sasinë e midhjeve në qendër për certifikim dhe etiketim apo depurim sipas klasifikimit.

Konkluzione:

1. Funkzionimi efektiv dhe mbarëvajtja e procesit të rritjes së rasatit të Koranit në Lin është e lidhur jetësisht me furnizimin me ujë nga burimi i fshatit po ashtu edhe me cilësinë e tij. Ndërhryrjet njerëzore të formave të ndryshme në burimin që furnizon ekonominë e rastit të Koranit në Lin, rrezikojnë parametrat e cilësisë së ujit si dhe rrjetin e furnizimit me ujë të kësaj ekonomie.
2. Mungesa e molit sjell uljen e efektivitetit të procesit të lëshimit të rasateve në liqen. Koha nga momenti i transportimit të rasatave nga vaska e rritjes deri në liqen si pasojë e mungesës së molit është më e gjatë. Sa më e gjatë të jetë koha e transportimit aq më shumë rritet mundësia e asfiksimit të rasateve në pajisjet që ato transportohen.
3. Ekonomia e rritjes së Krapit në Zvezdë ka një kapacitet prodhues prej 23 vaskash prodhimi, por aktualisht janë në kushte pune vetëm 13 prej tyre. Furnizimi me ujë i Ekonomisë së Zvezdës bëhet nga diga e Zëmbllakut e cila furnizon me ujë edhe fshatrat përreth dhe kjo bën të pamundur që kjo ekonomi të marrë sasinë e duhur të ujit dhe të funksionojë në mënyrë eficiente.
4. Ekonomia e rritjes së rasatit të Krapit në Zvezdë e zhvillon aktivitetin në mjedis të hapur, si rezultat mbarëvajtja e eficence e saj është e rrezikuar nga grabitqarët që dëmtojnë rasatin dhe peshkun. Gjithashtu banorët e zonës hedhin pesticide dhe kimikate pranë kanalit të ujit që furnizon ekonominë.
5. QGDM Sarandë me kapacitetin dhe teknologjinë që ka nuk mund të kalojë në qendër të gjithë sasinë e prodhimit të midhjeve. Mungesa e kapacitetit dhe teknologjisë bashkëkohore sjell ulje të efektivitetit të QGDM Sarandë.

Rekomandime:

1. MBZHR/DSHPA/Sektori i Akuakulturës të marrë masat e nevojshme për të siguruar furnizimin e mjaftueshëm me ujë të ekonomisë së rritjes së Koranit në Lin dhe ekonomisë së rritjes së Krapit në Zvezdë.

Dhjetor 2020

2. MBZHR/DSHPA/Sektori i Akuakulturës të marrë masat që cilësia e ujit që furnizon ekonominë e rritjes së Koranit në Lin të jetë brenda parametrave të duhura.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. MBZHR të bëjë të mundur financimin dhe ndërtimin e një moli në afërsi të Ekonomisë së rritjes së Koranit në Lin për të lehtësuar mbarëvajtjen dhe rritur efektivitetin e procesit të ripopullimit të liqenit të Ohrit.

Tetor 2020

4. DSHPA të paraqesë në MBZHR një plan mbi mundësitë e rritjes së kapacitetit të prodhimit (funktionimin e ekonomisë me kapacitet të plotë) në ekonominë e rritjes së Krapit në Zvezdë. MBZHR të marrë masa për të bërë të mundur funksionimin e ekonomisë me kapacitet të plotë.

Shtator 2020

5. DSHPA/Sektori i Akuakulturës të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e ekonomisë së rritjes së Krapit në Zvezdë nga grabitqarët duke rrethuar mjedisin ku zhvillon aktivitetin e rritjes së tij.

Qershor 2020

6. DSHPA/Sektori i Akuakulturës të marrë masa për të reduktuar ndotjen e kanalit që furnizon me ujë ekonominë e rritjes së Krapit në Zvezdë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. DSHPA/MBZHR të marrin masa për të rritur kapacitetin e QGDM Sarandë si dhe të përmirësojnë teknologjinë e saj me qëllim certifikimin dhe etiketimin e të gjithë sasisë së midhjeve të prodhuar në Liqenin e Butrintit si dhe çeljen e eksporteve.

Dhjetor 2020

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Auditimi i performancës me temë "Performanca e MBZHR-së në kuadër të zbatimit të politikave të peshkimit dhe akuakulturës" krahas përshkrimit të situatës në të cilën ndodhet peshkimi dhe akuakultura në vendin tonë ka synuar vlerësimin e performancës së strukturave të MBZHR-së dhe institucionit në varësi të saj DSHPA sa i takon zbatimit të politikave për peshkimin dhe akuakulturën. Ky auditim është fokusuar në nivelin e zbatimit të objektivave strategjike të vendosura në SKP 2016-2021, miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, inspektimin e aktivitetit të peshkimit, menaxhimin e porteve të peshkimit si dhe në burimet njerëzore dhe mjetet logjistike në dispozicion të tyre për përmbushjen e detyrave funksionale. Kushtet të cilat janë të nevojshme për të siguruar efektivitetin kanë të bëjnë me nivelin e performancës së subjekteve nën auditim. Në këtë auditim jemi përqëndruar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtorinë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës si institucion varësie i MBZHR-së. Periudha objekt auditimi është 2016-2018.

Masat e marra nga MBZHR në vitet 2016-2018 për menaxhimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës nuk kanë qenë të mjaftueshme. MBZHR nuk ka hartuar dhe

miratuar një sërë aktesh nënligjore duke dështuar në plotësimin e kuadrit ligjor të peshkimit dhe akuakulturës. Ligji i Akuakulturës i miratuar në vitin 2016 ende nuk ka gjetur zbatim si rezultat i mos miratimit të Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë duke penguar kështu zhvillimin e këtij sektori. Bashkëpunimi jo i mirë midis MBZHR-së dhe institucionit në varësi të saj DSHPA-së si dhe komunikimi i dobët institucional brenda MBZHR-së, janë tregues direkt të mos menaxhimit efektiv të veprimtarisë së peshkimit dhe akuakulturës. Pamjaftueshmëria në mjete logjistike dhe burime njerëzore bën që DSHPA të mos jetë efektive në inspektimin e aktiviteteve lidhur me peshkimin dhe akuakulturën. Mungesa e sistemit të sinjalizimit satelitor për monitorimin e anijeve të peshkimit bën të pamundur identifikimin e lëvizjes së anijeve, kontrollin e peshkimit të paligjshëm dhe regjistrimin e të dhënave në format elektronik. Të dhënat që grumbullohen dhe administrohen nga MBZHR për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës nuk janë të dhëna të besueshme dhe të sakta. MBZHR nuk ka një mënyrë të organizuar dhe të standardizuar për grumbullimin e të dhënave, ato mbledhen në mënyra të ndryshme, të tërthorta dhe nga persona të pa autorizuar.

Portet e peshkimit të vendit tonë menaxhohen në mënyrë jo efektive dhe kanë mungesë të hapësirave ankoruese, kantierëve për riparimin e anijeve të peshkimit si dhe furnizimit me ujë dhe energji elektrike. Ekonomitë e rritjes së rasatit të Koranit në Lin dhe Krapit në Zvezdë nuk furnizohen mjaftueshëm me ujë dhe cilësia e tij nuk është në parametrat e duhura. QGDM Sarandë nuk siguron që e gjithë sasia e prodhuar e midhjeve të kalojë në qendër për certifikim, etiketim apo depurim sipas klasifikimit. Mos zbatimi i “Objektivave Specifike Zhvillimore” të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit ka bërë që politikat e ndërmarra nga qeveria për këtë sektor të mos jenë efektive në drejtim të garantimit me cilësi të aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës. Rekomandimet për problematikat e identifikuar në këtë auditim kanë konsistuar në plotësimin e kuadrit ligjor të peshkimit dhe akuakulturës, riorganizimin e duhur strukturor të MBZHR-së në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit, mbulimin me inspektim të të gjithë zinxhirit të aktivitetit të peshkimit dhe sigurimin e mjeteve logjistike në dispozicion të inspektorëve të peshkimit si dhe përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme të porteve të peshkimit dhe ekonomive të akuakulturës. Konkretisht, MBZHR-së i është rekomanduar krijimi i Drejtorisë së Peshkimit plotësisht funksionale brenda MBZHR-së si një prej strukturave kryesore të peshkimit. Mbledhja rregullisht (të paktën një herë në vit) e Komisionit Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën dhe Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik është një tjetër rekomandim i lënë nga grupi i auditimit. Lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave strategjike MBZHR-së i janë lënë disa rekomandime si për shembull realizimi i një raporti vlerësimi mbi nivelin e përmbushjes së objektivave specifike zhvillimore të SKP-së, hartimi dhe miratimi i Planit të Zbatimit të Peshkimit etj. Përmirësimi i infrastrukturës në portet e peshkimit si dhe ngritja e strukturave të “*vëzhguesit*” dhe “*monitoruesit*” në përputhje me Ligjin nr. 64/2012, neni 125 i ndryshuar plotësojnë gamën e gjerë të rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit kundrejt MBZHR-së.

Rekomandimet e lëna nga DSHPA-së janë fokusuar më shumë në problematika që kanë të bëjnë me procesin e kontrollit dhe inspektimit, burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme për inspektim, si dhe hartimi e përpilimi i planeve të punës dhe masave

administrative që DSHPA duhet të marrë kundra llojeve të ndryshme të peshkimit të paligjshëm. Duke qenë se DSHPA nuk ka burime njerëzore të mjaftueshme dhe mjete logjistike të përshtatshme e bashkëkohore për të inspektuar të gjithë vijën bregdetare që ka vendi ynë, sipërfaqen e ujërave të brendshme dhe zinxhirin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës (inspektim në det, në port, në pikat e grumbullimit dhe tregtimit të produkteve peshkore), i është lënë rekomandim të marrë masat e nevojshme për të mbuluar me kontroll dhe inspektim aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës 24/7 duke shtuar numrin e inspektorëve. Lidhur me planet vjetore të inspektimeve, DSHPA-së i është lënë rekomandim përgatitja e tyre duke u bazuar një metodologji që mbështetet në vlerësimin e riskut, fondet, mjetet dhe burimet njerëzore në dispozicion. Një tjetër problematikë për të cilin grupi i auditimit ka lënë rekomandimin përkatës ka të bëjë me plotësimin e proces verbaleve nga inspektorët e DSHPA-së pa qenë prezent në kohë reale në inspektim. Në disa raste ata bazohen në konstatime të bëra nga struktura të tjera si Policia Kufitare apo Roja Bregdetare dhe plotësojnë këto proces-verbale pa qenë vetë në inspektim. Lidhur me menaxhimin e porteve DSHPA-së i është lënë rekomandim të hartojë dhe të dërgojë për miratim në MBZHR, “Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit” të saj ku si pjesë përbërëse të përfshijë edhe “Menaxhimin e porteve të peshkimit” si dhe të marrë masa për lirim dhe hapësirave ankoruese për anijet e peshkimit në portet e peshkimit. Rekomandime të tjera për DSHPA-në janë dhënë edhe për përmirësimin e kushteve të përgjithshme të ekonomive të rrasatit të Koranit në Lin, Krapit në Zvezdë dhe QGDM Sarandë.

Pyetjet e auditimit	Përgjigja e pyetjeve të auditimit	Struktura-t Përgjegjëse
1.1.1 A janë ngritur dhe a bashkëpunojnë si duhet strukturat që kanë përgjegjësi apo janë të përfshira në menaxhimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës?	JO. MBZHR nuk ka ndryshuar strukturën organizative të saj për të rritur kapacitetet që menaxhojnë aktivitet e peshkimit dhe akuakulturës. Në MBZHR ka mungesë të komunikimit, mosrakordim dhe bashkëpunim jo efektiv midis strukturave.	MBZHR DSHPA
1.1.2 Cilat kanë qenë fushat e ndërhyrjeve strukturore që MBZHR ka dhënë mbështetje në drejtim të peshkimit dhe akuakulturës?	Mbështetjet strukturore që janë dhënë për zhvillimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës gjatë viteve 2016-2018 janë minimale, madje një pjesë e fondeve të planifikuara nuk janë investuar.	MBZHR
1.2.1 A janë miratuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e peshkimit dhe të akuakulturës?	JO. Edhe pse Ligji i Peshkimit është miratuar në vitin 2012 ende ka akte nënligjore në zbatim të tij që nuk janë miratuar. Ligji i Akuakulturës i miratuar në vitin 2016 pothuajse nuk ka gjetur zbatim	MBZHR

	pasi si hap i parë janë miratimi i ZPA-ve që ende nuk është bërë.	
1.3.1 A ka MBZHR burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme për të përmbushur detyrat që i ngarkon legjislacioni përkatës?	JO. MBZHR nuk ka burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të mjaftueshme që të monitorojë, vëzhgojë, kontrollojë dhe inspektojë zbatimin e legjislacionit për peshkimin dhe akuakulturën.	MBZHR
1.4.1 A është efektiv menaxhimi i porteve nga OMP-të krahasuar me menaxhimin nga DSHPA, dhe a zbatohet marrëveshja e nënshkruar me MBZHR-në (DSHPA-në) për këtë menaxhim?	JO. Asnjë nga 4 portet e peshkimit nuk menaxhohet në mënyrë efektive. Menaxhimi i porteve nga OMP-të rezulton me më shumë probleme krahasuar me portet që menaxhon DSHPA. Për vitet 2016-2018 OMP-të nuk kanë zbatuar kushtet e marrëveshjeve në menaxhimin e porteve Durrës dhe Vlorë.	DSHPA MBZHR
1.4.2 A është efektiv menaxhimi i ekonomive të rasateve të koranit, krapit dhe QGDMS?	JO. Ekonomitë e rritjes së rasatit të Koranit dhe Krapit kanë probleme me furnizimin me ujë dhe cilësinë e tij. QGDM Sarandë ka kapacitete të ulta për etiketimin, certifikimin dhe depurimin e midhjeve, si dhe nuk siguron që e gjithë sasia e midhjeve të kalojë në qendër përpara se të hidhet në treg.	DSHPA

5. ANEKSE

Aneksi 1: Përmbledhje e investimeve për peshkimin dhe akuakulturën 2016-2018

Emërtimi	Viti 2016		Viti 2017		Viti 2018	
	Plan përfundimtar	Fakt	Plan përfundimtar	Fakt	Plan përfundimtar	Fakt
Programi Mbështetje për Peshkimin	363,500	362,045	114,350	93,693	231,892	170,108
Investime të Brendshme	77,420	77,198	21,100	947	61,542	9,948
Bashkëfinancim me K.L e TVSH për Projektin e Portit të ri të peshkimit në Durrës	77,420	77,198				
Ngritja e sistemit VMS (Instalimi i transponderave) për anijet e peshkimit			20,000	0		
Hartimi i projektit të zbatimit për "Ndërtimi i tregut të shitjes me shumicë të peshkut në Shëngjin"			960	828		
Hartimi i projektit të zbatimit për "Thellimi i kanalit Bistricë"			140	119		
Ndërtimi i Tregut të peshkut Shëngjin					50,042	5,155
"Pajisje Laboratorike" për Qendrën e Grumbullimit dhe Depurimit të Midhjes dhe Ekonomitë e rritjes së rasateve					5,000	4,793
"Blerje të bankinave të lëvizshme" për Portet e Peshkimit					6,500	0
Investime të Huaja	200,000	199,598	0	0	71,150	61,727
Dokumenti Sektorial për Peshkimin (IPA II)			0	0	71,150	63,237
Projekti për Portin e ri të peshkimit në Durrës	200,000	199,598				
Total Investime	277,420	276,796	21,100	947	132,692	73,185

Aneksi 2: Numri total i Inspektimeve, nr i gjobave dhe vlera e tyre

Viti	Nr. total i Inspektimeve	Nr. total i Inspektimeve që kanë rezultuar me shkelje (kanë marrë gjoba)	Vlera e gjobave të paguara	Vlera e gjobave në proces	Vlera e gjobave të falura nga KPSHA
2016	1271	58	1,362,000	1,031,000	300,000
2017	1409	44	495,000	530,000	-
2018	1452	70	1,092,000	3,310,000	750,000
Total	4132	172	2,949,000	4,871,000	1,050,000

Punoi: Grupi i auditimit. Të dhënat DSHPA/IP

6. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE

1. Ermira Vojka – Audituese e Lartë, Përgjegjëse e grupit të auditimit;
2. Aulent Guri – Kryeauditues, Anëtar i grupit të auditimit;
3. Marjana Lako – Audituese e Lartë, Anëtar i grupit të auditimit;
4. Keida Muça – Audituese e Parë, Anëtar i grupit të auditimit.